


SITUATA E PËRFSHIRJES SË PRINDËRVE NË EDUKIM NË SHQIPËRI



cde

centre for **democratic** education

unicef 



RAPORT STUDIMI

SITUATA E PËRFSHIRJES SË PRINDËRVE NË EDUKIM NË SHQIPËRI

Mbështetur nga:



Mars, 2008

Ky studim është përgatitur dhe mbështetur në kuadrin e programit për Arsimin Bazë të UNICEF-it dhe është zbatuar në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës si dhe Drejtoritë Rajonale të Arsimit të qarqeve Kukës, Dibër, Tiranë, Elbasan, Librazhd, Fier, Vlorë, Korçë, Pogradec dhe Gjirokastrë me ekspertizë të ofruar nga 'Qendra Për Arsim Demokratik' (CDE).

Përpunimi i të dhënave dhe grafikëve Elona Boce

Grupi i mbledhjes së të dhënave Mexhit Hajdari, Gjergji Çiço, Dhimitraq Zografi, Violeta Paço, Zenel Sina, Valbona Nathanaili, Brunilda Zyka, Kujtim Merzira, Marsejeza Qypi.

Përgjegjësjë e Programit për Arsimin Bazë në UNICEF

Dr. Aurora (Karaxha) Bushati, Profesore e Asociuar

Mbështetur nga UNICEF (Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët)

Rruga 'Skënderbej', Godina Volkswagen, Kati III.

Tiranë, Shqipëri.

Tel: (+335-4) 273 335

Fax: (+335-4) 243 775

<http://www.unicef.org/albania>

Ballina:

Përpunimi grafik:

Shtypi:

Fotua ilustrative nga sxc

Eduart Cani

Shtypshkronja Gent Grafik, Tiranë

Copyright © 2008 nga UNICEF

Situata e Përfshirjes së Prindërve në Edukim në Shqipëri

Përgatitur nga:

Linda Gjermani & Bardhyl Musai

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE	9
A. Hyrje.....	11
B. Qëllimi.....	11
C. Objektivat	11
D. Pritshmëritë.....	12
E. Metodologjia.....	12
F. Rezultatet e studimit.....	15
1. Prindërit	15
2. Mësuesit.....	29
3. Psikologët dhe punonjësit socialë të shkollave	32
4. Drejtuesit e shkollave.....	34
5. Organet drejtuese të arsimit	38
6. Pushteti vendor: Komuna dhe bashki.....	39
7. Shoqëria civile dhe organizatat ndërkombëtare	40
G. Përfundime.....	40
Arritje.....	40
Mangësi	42
H. Çfarë sugjeron përvoja ndërkombëtare	43
K. Këshilla për vendimmarrësit.....	45
SHTOJÇË	
Pasqyrë të dhënash të përmbledhura nga pyetsorët dhe intervistat.....	49

PËRMBLEDHJE

Përfshirja prindërore në Shqipëri ka arritur një nivel të ndjeshëm institucionalizimi, nëpërmjet pranisë së këshillave të prindërve dhe bordeve të shkollave. Mangësitë qendrojnë ende në çështjet që kanë të bëjnë me efektivitetin dhe vetëorganizimin e këtyre organizmave prindërore. Në shumicën e rasteve vihet re se vetë roli i prindërve është i kufizuar dhe janë mësuesit dhe drejtuesit e shkollave ata që thonë fjalën kryesore dhe në një farë mënyre i japin tonin veprimtarisë së këtyre strukturave prindërore.

Shoqatat e prindërve, të cilat janë format më të përparuara të vetëorganizimit të prindërve, paraqesin të njëjtin realitet. Shtrirja e tyre është e kufizuar dhe kryesisht në zonat ku donacionet janë më të lehta për t'u siguruar nga donatorët ndërkombëtarë. Kjo situatë e ka bërë ende të pamundur krijimin e një shoqate prindërore në nivel kombëtar, e cila do të transmetonte në mënyrë të besueshme zërin e prindërve tek institucionet arsimore vendimmarrëse. Krijimi i një organizate kombëtare prindërore e cila do të ishte përfaqësuese legjitime e masës së tyre do të duhet të kalojë nëpër një proces përfaqësimi nga poshtë-lart të shoqatave të prindërve në nivel vendor.

Nga ana e prindërve nuk ekziston ende ndërgjegjësimi i duhur për rolin që ata mund të luajnë në edukimin e fëmijëve të tyre në shtëpi dhe në shkollë, por ky rol i besohet më shumë shkollës dhe mësuesve. Tek këta të fundit vihet re interesimi dhe prirja për të ndarë me prindërit detyrat e edukimit të fëmijëve. Bashkëpunimi me prindërit mësohet më tepër nëpërmjet përvajës së punës se sa nëpërmjet trajnimeve të organizuara dhe formimit fillestar. Këtu ka shume vend për përmirësim, ashtu siç ka vend për më shumë përfshirje të psikologëve dhe punonjësve socialë të shkollave në komunikimin dhe bashkëpunimin shkollë-prindër.

Në tërësi, përfshirja e prindërve në çështjet e edukimit ka arritur por edhe nevojë për hapa të vendosura duke dhënë së pari sinjale të fuqishme pozitive nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Drejtoritë arsimore rajonale.

A. Hyrje

Qendra për Arsim Demokratik e mbështetur dhe financuar nga UNICEF, ka ndërmarrë një studim në fushën e arsimit, që synon të përmirësojë cilësinë e arsimit të fëmijëve, duke nxitur përfshirjen e prindërve në shkollë dhe bashkëpunimin me mësuesit. Ajo çka synohet është njëkohësisht edhe demokratizimi i mëtejshëm i arsimit dhe bërja e tij më i hapur për klientët, gjë që do të pasqyrohet në një edukim më të mirë për fëmijët.

Duke marrë parasysh se përmirësimet dhe reformat në këtë drejtim duhet të ndërmerren vetëm duke njohur mirë gjendjen ekzistuese, studimi ka patur si veprimtari kryesore vlerësimin e situatës ekzistuese në të gjitha qarqet e Shqipërisë, dhe ballafaqimin me përvojën evropiane, për të dalë me një plan masash dhe veprimesh që do të sjellin si rezultat një pjesëmarrje më intensive dhe të organizuar të prindërve në çështjet e arsimit, në të gjitha nivelet. Për këtë, studimi është kryer në rang vendi duke marrë parasysh të gjitha arritjet aktuale, dhe po ashtu edhe problemet dhe pengesat. Rezultatet e studimit janë një element që do të përdoret *për hartimin e një Plani Veprimi për rritjen e pjesëmarrjes së prindërve në arsim, i cili do të miratohet nga MASH dhe do të bëhet platforma drejtuese për rritjen e nivelit të përfshirjes së prindërve në edukim*, në të mirë të fëmijëve dhe të realizimit të të drejtës së tyre për një arsim cilësor dhe dinjitoz.

B. Qëllimi

Qëllimi i studimit është që të përmirësohet cilësia e edukimit të fëmijëve, duke ngritur nivelin e përfshirjes prindërore në jetën e shkollës dhe në çështjet e arsimit në tërësi.

Studimi synon t'u ofrojë hartuesve të politikave arsimore dhe aktorëve të arsimit rezultatet e një studimi të gjërë mbi përfshirjen e prindërve në arsim, dhe më tej, një plan veprimi, për të hedhur hapa përpara në këtë drejtim.

Kjo veprimtari do të hedhë bazat për një reformë në nivel kombëtar, që do të fuqizojë rolin e prindërve dhe të komunitetit, duke filluar që nga niveli i shkollës e deri tek hartimi i politikave arsimore.

C. Objektivat

Objektivat e studimit ishin:

1. Të bëhet një vlerësim i inventarit të përvojave dhe praktikave ekzistuese, që kanë të bëjnë me përfshirjen e prindërve dhe komunitetit në sistemin arsimor, në 12 qarqe të vendit.

2. Të identifikohen të paktën 6 drejtime kryesore për ndryshime lidhur me përfshirjen e prindërve dhe komunitetit, nëpërmjet një studimi krahasues të përvojës shqiptare me atë të dy vendeve të tjera, me përvoja të zbatueshme në kushtet e Shqipërisë.
3. Bazuar në dy studimet e mësipërme, të hartohet një Plan Veprimi për t'u miratuar dhe zbatuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Ky plan do të synojë rritjen e pjesëmarrjes së prindërve dhe komunitetit në problemet e arsimit. Zbatimi do të përfshijë në mënyrë aktive Drejtoritë Arsimore Rajonale.

D. Pritshmëritë

Pritshmëria për studimin është të njihet gjendja reale e përfshirjes prindërore në arsim në të gjitha nivelet, si dhe të mblidhet një dokumentim i përvojës së krijuar për bashkëpunimin prindër-shkollë. Studimi është kryer në periudhën tetor-nëntor 2006 (mbledhja e të dhënave në terren) ndërsa përpunimi, analizimi i tyre dhe formulimi i raportit, në periudhën dhjetor 2006-mars 2007. Studimi është bazuar në bërjen e pyetsorëve dhe intervistave me prindërit, me organet arsimore të niveleve të ndryshme, si dhe mbledhjen e dokumentacioneve përkatëse.

Si një përfundim i përgjithshëm mund të thuhet se nga studimi rezulton se ka arritje dhe përparim në drejtim të përfshirjes së prindërve në edukim në rang vendi, si psh në drejtim të instalimit të bordeve të shkollave dhe këshillave të prindërve, por njëkohësisht edhe dobësi, si psh në pavarësinë e funksionimit të organizmave të prindërve, në punën e shoqatave të prindërve, në bashkëpunimin me DAR, pushtetin vendor dhe MASH, si dhe në nivelin e tyre të përgjithshëm të ndërgjegjësimit për rolin që kanë si edukues të fëmijëve. Po kështu, edhe mësuesit kanë nevojë për më shumë njohuri dhe shprehje praktike për ndërtimin e bashkëpunimit me prindërit.

E. Metodologjia

Mbledhja e të dhënave për studimin është bërë nëpërmjet pyetësorëve dhe intervistave të shpërndara në 12 rrethe të vendit. Njëkohësisht, kudo ku ka qenë e mundur, janë kërkuar dhe mbledhur materiale dokumentuese që paraqesin punën dhe veprimtaritë e bëra nga shkollat ose organizatat e ndryshme në fushën e arsimit, lidhur me bashkëpunimin me prindërit.

Pyetësorët dhe intervistat janë zhvilluar në 12 rrethe: Burrel, Peshkopi, Elbasan, Librazhd, Fier, Gjirokastrë, Has, Korçë, Pogradec, Kukës, Tiranë, Vlorë. Pyetësorët janë hartuar në tre lloje: për prindërit, për mësuesit dhe për drejtuesit e shkollave. Me drejtuesit e shkollave janë zhvilluar edhe një numër intervistash për të mbledhur mendime, që ndoshta mund të mos shpreheshin dot nëpërmjet pyetësorit, si dhe për të verifikuar qendrimet e tyre nëpërmjet një mjeti tjetër të mbledhjes së të

dhënave. Pyetëtorët për të trija grupet, kanë synuar në mbledhjen e informacionit specifik për secilin grup por, njëkohësisht, edhe verifikimin e informacionit nëpërmjet metodës së triangulimit, ose ndryshe me përsëritjen e pyetjeve për të njëjtën çështje në të trija grupet, për të parë se sa të afërta ose të ndryshme janë përgjigjet.

Numri total i pyetësorëve të plotësuar nga prindërit është 775, ndërkohë që janë dërguar mbi 1000 pyetësorë. Nga këto 35,7 % janë shpërndarë dhe plotësuar në zonat e fshatrave dhe 62,2 % në qytete. Mospërgjigjet përbëjnë 2,1% (pra pyetësorë të mbledhur por të dorëzuar pa plotësuar pyetjet). Numri i pyetësorëve për mësuesit është 175 për të gjitha rrethet, nga ku 33% në fshat, 59,1 % në qytet dhe 8% të papërcaktuar. Ndërsa, numri i pyetësorëve për drejtuesit e shkollave është 44 gjithësej, sipas shpërndarjes: fshat 36,4%, qytet 52,3 % dhe 56,8% në shkollat 9-vjeçare.

Janë zhvilluar gjithësej 55 intervista nga të cilat: 9 me përfaqësues të DAR dhe zyrave të arsimit në rrethe, 17 me drejtorë shkollash, 6 me punonjës socialë dhe psikologë shkollash, 8 me përfaqësues të pushtetit vendor në komunë ose bashki, 3 me përfaqësues të këshillave të prindërve, 5 me përfaqësues të shoqatave të prindërve, 2 me antarë bordi shkollash, 1 me prind (pa specifikuar pozicionin), 3 me punonjës të organizatave ndërkombëtare që punojnë për pjesëmarrjen prindërore në arsim, dhe 1 me përfaqësues të MASH.

Ekipi i intervistuesve është përbërë nga 20 vetë, të shpërndarë në grupe 2-3 vetësh për çdo rreth. Intervistuesit janë trajnuar paraprakisht në 2 grupe për mënyrën e zhvillimit të intervistave dhe administrimin e pyetësorëve, si dhe për qëllimet dhe objektivat e studimit, për t'u dhënë një pamje dhe orientim më të gjërë të të gjithë veprimtarisë ku janë përfshirë. Gjatë trajnimit dolën në pah mjaft pika interesante, që u morën parasysh gjatë procesit të administrimit të pyetësorëve dhe intervistave.

Përzgjedhja e intervistuesve është bërë nga rradhët e punonjësve të arsimit dhe një nga mesazhet e dhëna gjatë trajnimit të tyre ishte krijimi i një mjedisi sa më të përshtatshëm e konfidencial për intervistën, por njëkohësisht edhe neutral e jo-sugjerues, me qëllim që të tërhiqen mendimet autentike të të intervistuarve dhe të minimizohen gabimet në interpretimet e të dhënave të mbledhura. Intervistat kanë qenë gjysëm të strukturuar. Intervistuesit kanë patur parasysh një sërë tematikash për të cilat do të pyesnin, por jo një seri pyetjesh të paracaktuara. Kjo është bërë për t'i dhënë mundësinë çdo interviste që të përshtatet me veçoritë e funksionit zyrtar dhe personalitetit njëzëz të të intervistuarit.

Një nga aspektet e theksuara gjatë shpërndarjes së pyetësorëve dhe bërjes së intervistave ka qenë ruajtja e anonimatis të atyre që janë përgjigjur. Në çdo rast është bërë e qartë se identiteti i personave të përgjigjur nuk do të njihet nga ekipi i studimit (është fjala për pyetësorët) ndërsa për të intervistuarit, përsëri ata mund të mbeten anonimë, ose identiteti i tyre do të njihet vetëm nga studjuesit dhe

formuluesit e raportit, por në asnjë rast nuk do të bëhet objekt informacioni për eprorët e tyre ose mësuesit. Arsyeja ka qenë zbatimi i normave etike të studimit dhe nga ana tjetër, krijimi i një fryme besimi dhe çiltërsie nga personat e përgjigjur, me qëllim që të merret një informacion sa më real e i besueshëm.

Mospërgjigjet kanë qenë në përqindje të vogël, pra të neglizhueshme, dhe në tërësi mund të pohohet se pyetësorët dhe intervistat kanë siguruar një kampion të besueshëm përse i përket përgjithësimin të të dhënave (vlefshmëria e jashtme e studimit).

Rrethet ku janë zhvilluar, gjithashtu përbëjnë një kampionim mbulues nga pikëpamja gjeografike. Përse i përket shpërndarjes në qytete e fshatra, edhe kjo ka qenë relativisht e mirë, ndonëse me një farë mbizotërimi të pyetësorëve në qytete. Megjithë udhëzimet e dhëna ndaj grupit administrues të pyetësorëve dhe të intervistave, për të mbuluar në masën rreth 50% me 50% fshatin dhe qytetin (shifër që ndodhet më afër shpërndarjes së popullsisë në vend 60-40) shpërndarja aktuale pasqyron vështirësitë e infrastrukturës për të arritur në zonat fshatare mbrenda ditëve dhe kostos në dispozicion të studimit. Megjithatë, rezultatet pasqyrojnë në një masë të mirë gjendjen si në qytet ashtu dhe në fshat, dhe veçoritë, sidomos për zonat fshatare, kanë dalë në pah mjaftueshëm.

Studimi i materialeve dhe modeleve të zhvilluara nga shkollat dhe DAR-et është bërë për të *evidentuar ekzistencën e materialeve të gatshme, të cilat mund të përdoren në masë edhe nga shkolla dhe DAR-e të tjera të vendit*, por nga ana tjetër, edhe për të verifikuar saktësinë e përgjigjeve të dhëna nëpërmjet pyetësorëve dhe intervistave. Materialet me të mira ilustruese janë mbledhur në rrethin e Elbasanit dhe Librazhdit. Gjithsesi, mund të thuhet se këto materiale dhe dokumentacione kanë qenë deficiente në studim, gjë që në një farë mënyre pasqyron faktin se ajo që bëhet për përfshirjen e prindërve nuk është plotësisht e institucionalizuar.

Pyetësorët janë përpunuar paraprakisht me SPSS (Statistical Package for Social Scientists softëare), gjë që ka lehtësuar nxjerrjen në pah të anës sasiore të të dhënave dhe të disa rezultateve fillestare. Gjithsesi, raporti është bazuar në përfundime që janë nxjerrë duke përfshirë edhe intervistat dhe materialet e mbledhura si: fletore komunikimi me prindërit, fletëpalosje për prindërit e prodhuar nga drejtorja e shkollës, platforma vlersimi e kontrolli të shkollave të hartuara nga DAR, etj. Analiza e të dhënave dhe nxjerrja e konkluzioneve është paraqitur duke analizuar veçmas prindërit dhe shkollat (mësuesit, drejtuesit, psikologët) si dhe organet drejtuese të arsimit si DAR, MASH dhe organet e pushtetit vendor. Megjithatë, brenda çdo grupi të analizuar, përfundimet janë përmbledhëse dhe përfshijnë edhe mendimet dhe vlersimet e bëra nga grupet e tjera.

F. Rezultatet e studimit

1. Prindërit

Pyetsorët dhe intervistat me prindërit kanë synuar të mbledhin informacion lidhur me shpeshhtësinë dhe cilësinë e kontakteve të tyre me shkollën nëpërmjet takimeve me prindër, funksionimin dhe nivelin e përfaqësimit dhe të demokracisë në organet e përfshirjes prindërore si: këshillat e prindërve, bordet e shkollave dhe shoqatat e prindërve, barrierat që ata hasin për bashkëpunimin, si dhe mendimet dhe sugjerimet e tyre për të rritur nivelin e pjesëmarrjes.


Më poshtë do të paraqiten rezultatet për secilën nga çështjet e mësipërme:

Takimet me mësuesit dhe shkollat

Shumica dërrmuese e prindërve pohojnë se takimet me prindër në shkollë organizohen një herë në dy javë, një shpeshhtësi kjo, që nëqoftëse është e besueshme, është mjaft e mirë. E njëjta gjë konfirmohet edhe nga mësuesit, por tek ata ka edhe përgjigje që takimet zhvillohen një herë në muaj ose një herë në dy muaj, përgjigje që tek prindërit mungon. Kur bëhet pyetja se sa herë janë paraqitur ata në takimet me prindër gjatë vitit shkollor, përgjigjet variojnë në një diapazon të gjerë, ku shpeshhtësia më e madhe është për 3 herë në vit, e pasuar nga ajo e 9 dhe 8 herë në vit, dhe pastaj 5 dhe më pas 2 herë në vit. Përqindja e prindërve që nuk kanë shkuar asnjë herë ose vetëm një herë në takim, është fare e vogël. **Kjo shpërndarje është disi e veçantë dhe me shprehje mes vlerave gjë që sugjeron se është diçka që duhet të rishikohet për t'u konfirmuar nga studime të tjera.**

Përsa i përket cilësisë së takimeve, prindërit demostrojnë një nivel të lartë pëlqimi për mënyrën e organizimit të tyre si dhe përgatitjen e mësuesve për këto takime. Gjithashtu, ata pohojnë se kanë kohë të mjaftueshme në dispozicion për të biseduar me mësuesit dhe për të bërë pyetjet që i shqetësojnë. Ky duket një rezultat pozitiv, por vëmendja duhet të tërhiqet në dy çështje që ndihmojnë në interpretimin e tij që janë: *niveli i ulët i përgatitjes dhe interesimit të prindërve në këto takime*, siç pohohet nga shumë mësues dhe drejtues shkollash (pra prindërit nuk vijnë të përgatitur me shumë pyetje dhe janë deri diku të druajtur për të hyre në diskutime/debate me mësuesit), dhe se në *takimet me prindërit rrallë vijnë më shumë se 50% e tyre* (duke llogaritur një prind për fëmijë). Një shifër e tillë përmendet nga shumë mësues e drejtues shkollash në rrethe të ndryshme, dhe disa nga ata pohojnë se do të ishin të lumtur sikur të vinin në takime 50% e prindërve. Në kushtet e një rritjeje të nivelit të interesimit dhe të pjesëmarrjes së prindërve, ndoshta shkollat dhe mësuesit do të viheshin përpara pamjaftueshmërisë së kohës dhe para kërkesës për një përgatitje shumë më të mirë për mbledhjet, në mënyrë që prindërit të ruanin të njëjtin nivel vlersimi për cilësinë dhe shpeshhtësinë e takimeve. Me fjalë të tjera, **konkluzioni është që: prindërit janë të kënaqur, por në kushtet e një përfshirjeje jooptimale dhe të kufizuar**. Një bashkëpunim dhe prani më e madhe e prindërve në shkollë do të duhet t'i gjejë shkollat dhe mësuesit shumë më të përgatitur profesionalisht.

Lidhur me përmbajtjen e diskutimeve gjatë takimeve prindërit rendisin si çështjet më të diskutuara (sipas rendit zbritës): notat në mësim, sjelljen e fëmijëve, problemet me tekstet, kushtet fizike të shkollës, problemet me mjetet mësimore, veprimtaritë shkollore, dhe problemet financiare të shkollës. Kjo shpërndarje nuk rezultoi në papritur, me përjashtim disi të problemeve me tekstet, ku duket se prindërit janë mjaft të përfshirë. Parë në këndvështrimin e asaj që u tha me lart, lidhur me nivelin e ulët të pjesëmarrjes së prindërve, kjo tingëllon me tepër si një pasqyrim i problemeve dhe vështirësive që përjetojnë fëmijët me tekstet. Ndonëse përfshirja e prindërve në vlersimin e programeve mësimore dhe deri diku edhe të teksteve do të ishte mjaft e pëlqyeshme, **për kushtet e tanishme një rezultat i tillë i interesimit për tekstet mund të shpjegohet me tepër si një reagim ndaj cilësisë së dobët të disa prej tyre. Kjo duhet të merret si një sinjal që nuk duhet anashkaluar nga MASH lidhur me nevojën për të rishikuar cilësinë e teksteve mësimore dhe përshtatjen e tyre me veçoritë psikologjike moshore dhe të nxëniet të fëmijëve.**




Vendi i zhvillimit të takimeve me prindër ka mjaft rëndësi për sigurimin e efektivitetit të tyre por njëkohësisht është edhe një mesazh që jepet nga shkolla për rëndësinë që kanë prindërit në punën e saj. Pyetjeve për këtë çështje **shumica e prindërve i janë përgjigjur se janë të kënaqur me vendin ku zhvillohen takimet** (mjedis i qetë dhe i përshtatshëm). Sipas përgjigjeve të prindërve, shumica dërrmuese e takimeve me prindër zhvillohen brenda në klasë (89,4%) dhe vetëm 4,4% pohojnë se ato zhvillohen në korridore. Gjithashtu, përqindja e takimeve që zhvillohen në oborr është fare e vogël (1,3%). Lidhur me mundësinë për t'u takuar dhe biseduar edhe me drejtues të shkollës gjatë takimeve të tilla, përgjigjet janë 44% për mundësi të shpeshta, 32% për nganjëherë dhe pjesa tjetër për rrallë dhe asnjëherë. **Ky rezultat terheq vëmendjen përsa i takon gatishmërisë dhe përgatitjes së drejtuesve të shkollave për të qenë të pranishëm dhe bashkëpunues gjatë takimeve me prindër.** Është fakt që mjaft prindër mund të kenë probleme për të trajtuar që shkojnë përtej mësuesit kujdestar ose të lëndës dhe që në disa raste mund të kenë të bëjnë pikërisht me vetë këta mësues dhe për rrjedhojë, është ekipi drejtues i shkollës partneri me i përshtatshëm për të diskutuar dhe zgjidhur.

Çuditërisht befasues në kahun pozitiv, është pohimi nga 63% e prindërve se mësuesit janë shpesh të gatshëm të takohen me ta për probleme individuale të fëmijëve të tyre jashtë orarit të takimeve me prindër. 24,5% e prindërve pohojnë se kjo ndodh nganjëherë dhe vetëm 1,9% thonë se nuk ndodh asnjëherë. Ky përfundim dëshmon një gatishmëri të mësuesve e cila duhet shfrytëzuar për të rritur kontaktet me prindërit. Nga ana tjetër pyetjes: "Sa herë thirrreni nga mësuesit për takime individuale?", 32% e prindërve i përgjigjen "asnjëherë", 6,1% "një here", 11,5% "dy herë", dhe 8,6% "3 herë". Rezultati mund

të interpretohet që: **ndërsa mësuesit janë përgjithësisht të gatshëm të presin prindërit për takime individuale, ata nuk janë po aq aktive në thirrjen e prindërve për takime të tilla.** Gjithsesi, rezultati është i pritshëm duke marrë parasysh kohën e kufizuar në dispozicion të mësuesve për të zhvilluar takime me prindër të veçantë.

Ajo çka këshillojnë prindërit lidhur me përmirësimin e takimeve që organizohen në shkollë është:

- Takimet me prindër të zhvillohen më shpesh dhe me tematika të caktuara sipas nevojës, dhe jo thjesht për raportim për notat e nxënësve.
- Takimet, kurdo që të jetë e mundur të ndiqen nga përfaqësues të organeve arsimore, si për të ushtruar kontroll mbi këtë aspekt të punës së mësuesve dhe shkollave, po ashtu dhe për t'u njohur me kërkesat e prindërve.
- Takimet të bëhen të planifikuara që në fillim të vitit shkollor dhe të njoftohen në kohën e duhur
- Mësuesit dhe shkolla duhet të përgatiten më mirë për këto takime dhe të krijojnë një atmosferë ku prindërit ta ndiejnë veten të lirshëm për të shprehur mendimet dhe pakënaqësitë e tyre.
- Te bëhen takime me praninë e bordit të shkollës dhe qeverisë së nxënësve.
- Prindërit të marrin pjesë në mbledhjet tematike të drejtorisë së shkollës.
- Takimet të mos bëhen vetëm në raste emergjence apo problemesh por edhe për aktivitete të përbashkëta si ditëlindje, piknike, ekskursione, shikim filmi, teatri, apo aktiviteti sportiv. Duhet të organizohen më shumë takime sensibilizuese për problemet e shkollës, që prindërit të qendrojnë më pranë dhe të ndikojnë pozitivisht në zgjidhjen e tyre.



Shkaqet kryesore që pengojnë një komunikim dhe bashkëpunim më të mirë të prindërve me shkollën

Sipas vetë prindërve këto janë :


- Ngarkesa e prindërve me aktivitete, punë dhe angazhime të tjera, problemet e tyre ekonomike dhe sociale (që përbëjnë arsyen e përmendur më shpesh nga ana e tyre)
- Indiferenca e tyre në kontrollin e fëmijës
- Indiferenca dhe moskomunikimi me mësuesit dhe drejtuesit e shkollës
- Organizimi i një numri të pakët mbledhjesh me prindër si dhe bërja e tyre jo në kohën e duhur
- Mungesa e motivimit dhe kualifikimit të mësuesve
- Mosinformimi për atë që ndodh në shkollë
- Anashkalimi i rolit të prindërve për atë që ndodh në shkollë dhe në partneritetin mes tyre dhe mësuesve
- Mendësia, niveli arsimor dhe kulturor i prindërve,
- Rezultatet e dobëta të fëmijës
- Ngarkesa e mësuesve

Dy elementet e fundit janë mjaft interesante. Ndonëse ka prindër që përmendin si faktor ngarkesën e mësuesve, këta janë vetëm një pakicë. Pra, kemi një **mungesë perceptimi të prindërve lidhur me ngarkesën në punë të mësuesve si pengesë për një bashkëpunim me të frytshëm mes tyre**. Po kështu, relativisht pak prindër kanë përmendur faktin se rezultatet e dobëta të fëmijës përbëjnë një arsye për prindin për të mos ardhur në shkollë, por kjo përmendet nga shumë mësues dhe nga disa drejtues shkollash. Është fakt i njohur, siç pohohet prej tyre, që **prindërit që vijnë më rrallë janë ata që kanë fëmijë me më shumë probleme**. Kjo mund të ketë disa shpjegime të karakterit social e ekonomik, por edhe psikologjik. Familjet që kanë probleme sociale: emigracion, divorce, sëmundje të prindërve, paaftësi të tyre fizike e mendore, numër të madh fëmijësh ose të moshuarish për t'u kujdesur, kanë më pak mundësi që të jenë të pranishëm në shkollë. Përpjekjet e tyre për mbijetesën e familjes nuk u lenë kohën dhe energjinë nevojshme për t'u marrë as duhet me edukimin e fëmijëve.

Një prind shpreh një ide interesante, por edhe praktike për takimet me prindër "te cilat nuk duhet të bëhen në të gjitha shkollat në të njëjtën ditë dhe orë, që prindërit të kenë mundësi të shkojnë te shkollat e të gjithë fëmijëve që kanë". Takimet duhet të planifikohen nga shkollat në mënyrë të tillë që të jenë sa më të lehta për t'u ndjekur nga prindërit si përsa i takon ditës po ashtu edhe orës.

Por, ka edhe raste kur prindi nuk të tilla probleme, por thjesht për arsye të ndryshme, rezultatet e fëmijës në mësim nuk janë të kënaqshme, dhe ai e ndjen veten në pozitë jo të mirë për të ardhur në shkollë. Ajo që këta prindër dëgjojnë nga mësuesit është shpesh e njëjta gjë: "fëmija yt është shumë dobët, nuk ka patur asnjë përmirësim", dhe jo rrallë ka edhe etiketime më të veshtira për t'u pranuar nga prindi. Në kushtet kur një komunikim i tillë bëhet në prani të shumë prindërve të tjerë, mund të imagjinohet që motivimi për të takuar mësuesin do të jete minimal. Ajo që e thekson akoma më shumë këtë, është edhe mungesa e alternativave pedagogjike nga mësuesit dhe pamundësia e tyre për të ndërtuar programe bashkëpunimi individuale me prindër të nxënësve të tillë. Jo rrallë, këta nxënës vijnë nga familje me një nivel më modest arsimimi dhe kjo i bën prindërit edhe me të pafuqishëm dhe pesimistë për t'u përballur me mësuesit. Këto argumenta nuk përbëjnë aspak

justifikim për gjendjen, por kërkojnë gjetjen e alternativave të tjera për të komunikuar në mënyrë të përshtatshme me këta prindër.



Një nga mundësitë që përmendin vete mësuesit si dhe DAR-et, janë **vizitat në shtëpitë e nxënësve**. Një mundësi që duhet të përdoret paralelisht është krijimi i kushteve në shkollë për një bisedë dhe komunikim më konfidencial midis mësuesit dhe prindit, pa praninë e mësuesve, prindërve e nxënësve të tjerë, që presin rradhen të bisedojnë me mësuesin.

Sugjerohet që të **ketë në shkollë "dhomë të**

prindërve” ku mund të bëhen këto takime dhe ku mund të mblidhen këshillat e prindërve dhe bordi i shkollës, si dhe të lenë aty dokumentacionin e tyre.

Si mendojnë prindërit se mund të përmirësohet bashkëpunimi i tyre me shkollën

Nëpërmjet pyetësorit, prindërit kanë dhënë ide praktike se si mund të intensifikohet ky bashkëpunim. Mjaft prej këtyre ideve janë përmendur edhe nga grupe të tjera si psh psikologët e shkollave, etj. Konkretisht, **prindërit janë të ndërgjegjshëm se bashkëpunimi nuk është optimal, por ka shumë mundësi reale për ta përmirësuar atë**. Prindërit shprehen mjaft pozitivisht lidhur me punën e bërë nga mësuesit dhe kërkojnë nga ata më shumë ngrohtësi, dashamirësi dhe mirëpërgatitje.

Bie në sy si qendrimi dashamirës ndaj mësuesve, po ashtu edhe ai kritik. Dashamirësia dhe respekti shprehen nëpërmjet njohjes se rolit të pazëvendësueshëm që kanë mësuesit, cilësia e mësimdhënies së tyre dhe motivimi, në edukimin e fëmijëve dhe në arritjen prej tyre të rezultateve të larta.

Ja se si shprehet njëri nga prindërit: “Nëse dëshirojmë të kemi një shkollë të shëndoshë, një bashkëpunim të shëndoshë, një mbarëvajtje të fëmijëve tanë në shkollë, mendoj se duhet të rriten pagat e mësuesve, që janë truri i këtij kombi dhe janë me të diskriminuarit nga ana financiare. Nëse ata do të jenë të kënaqur dhe të motivuar, fëmijët tanë do të edukohen më mirë”.

Aspekti kritik bie në sy lidhur me nivelin arsimor të mësuesve (mungesa e arsimit përkatës në disa raste), ose dhënie mësim e lëndëve që nuk janë specialitet i tyre. Prindërit thonë se ka mësues që nuk shpjegojnë si duhet, dhe që me qëllim vlerësojnë më poshtë nxënësit, për të justifikuar dhënien e kurseve private ose lënien e nxënësve në vjeshtë për qëllime përfitimi. Ata kërkojnë kushtimin e një vëmendjeje më të madhe ndaj këtyre dukurive. *Prindërit venë theksin tek krijimi i një klime më të mirë bashkëpunimi, ku rol parësor kanë shkolla dhe mësuesit.*

Është një ilustrim i mirë i rëndësisë që ka respekti i prindërve ndaj shkollës për të kultivuar marrdhënie të vërteta bashkëpunimi. Ky respekt mund të krijohet nëse shkolla vërtet bën detyrën e saj në mënyrë të rregullt dhe me transparencë. Diçka të njëjtë në thelb kërkojnë prindërit edhe kur është fjala për kontributet financiare për shkollën: transparencë!

Lidhur me tërheqjen e mendimeve të tyre në shkollë prindërit sugjerojnë **zhvillimin e anketimeve të herëpashershme me ta nga mësuesit dhe shkolla**, për të bërë të mundur që prindërit dhe nxënësit të shprehin problemet që do të donin të parandaloheshin ose të zgjidheshin. **Vendosja e një kutie postare në shkollë** këshillohet si një alternativë paralele që duhet të përdoret me qëllim që prindërit të bëjnë të pranishme shqetësimet e tyre në drejtim të organizimit të mësimi, teksteve, bazës materiale, sjelljes, kushteve të shkollës, etj. Prania e një mjeti të tillë do të ishte shumë lehtësuese, sidomos për atë kategori prindërisht që kanë më pak mundësi të vijnë në shkollë për shkak të angazhimeve të ndryshme apo problemeve të tjera. Edhe prindërit ngrenë nevojën për të patur një mjedis të tyrin në shkollë ku ata të mblidhen rregullisht, të organizohen, të informohen, etj. Ata janë gjithashtu


në favor të **përfshirjes së tyre në projekte** që ndihmojnë jetën në shkollë dhe bashkëpunimin me qeverinë e nxënësve dhe me mësuesit.

Prindërit **janë njëkohësisht të hapur ndaj trajnimeve të ndryshme që mund të japë shkolla**, sidomos përse i përket çështjeve të edukimit të fëmijëve. Ata përmendin edhe nevojën për të futur në shkollë punonjësin social dhe psikologun. *Fletorja e komunikimit me mësuesit apo librezat e nxënësve* përmenden si mjete të nevojshme të komunikimit dhe të informimit. Në këto fletore mësuesi kujdestar duhet të shënojë jo vetëm rezultatet e fëmijës, por të kërkojë edhe mendim nga prindërit se si mund të zgjidhen më mirë problemet dhe vështirësitë. Një kërkesë shumë legjitime e prindërve është që **shqetësimet që ata shprehin tek mësuesi kujdestar, drejtorja e shkollës apo edhe këshilli i prindërve dhe bordi, të ndiqen deri në fund dhe të transmetohen në organet më të larta**, si MASH, derisa të futen në rrugën e zgjidhjes.

“Unë si prind mund t’i përmirësoja marrëdhëniet me shkollën, në rast se shkolla plotëson kushtet normale të mësimdhënies dhe eliminon problemet e mitmarrjes e të mësimdhënies së parregullt”- prind.

Prindërit i referohen edhe *nevojës që kanë për t’u njohur më mirë me legjislacionin arsimor, Dispozitat Normative të shkollave dhe rregulloren e shkollës* për të patur më të qartë rolin dhe hapësirat e tyre, dhe njëkohësisht detyrimet reciproke. Ndërkohë, pohohet se ata po marrin gjithnjë e më shumë pjesë në Këshillin e disiplinës në shkollë, për marrjen e masave disiplinore për nxënësit. Kjo duket shumë e drejtë pasi masat disiplinore janë një çështje delikate që kërkon mbështetjen e prindërve. Gjithashtu, çështja e frekuentimit, apo ndjekjes së shkollës, përmendet si një nga ato ku nuk mund të bëhet thujasë asgjë pa bashkëpunimin me prindërit dhe mbështetjen e tyre. Edhe përdorimi i uniformes është një nga aspektet e rëndësishme ku duhet përkrahja nga prindërit dhe pëlqimi i tyre për llojin e saj. Prindërit, gjithashtu, kanë qenë shumë të pranishëm në zgjidhjen e problemeve të infrastruktures fizike të shkollave dhe mbështetjen e tyre materiale dhe financiare.

A tregojnë mësuesit gadishmëri për tu takuar me ju, kur është e nevojshme, madje dhe jashtë orarit të takimit të caktuar me prindër



Organet e përfaqësimit prindëror

Këshillat e prindërve përmenden nga prindërit si organet e përfaqësimit të tyre që funksionojnë më mirë. 83,5% e prindërve e pohojnë këtë. Vetëm 14,7 % thonë se ato nuk funksionojnë. Pyetja ka qenë përmbledhëse, si për këshillat e klasës edhe për atë të shkollës, pa bërë specifikime. Pavarësisht se e përgjithshme është pozitive, shifra 14,7% është serioze dhe për t’u marrë në konsideratë për faktin se këshillat e prindërve në shkollë janë të detyrueshme sipas Dispozitave Normative. Qoftë

edhe një përqindje e vogël e mosfunksionimit të tyre, do të ishte e papranueshme. Megjithatë, shifra është e interpretueshme për sa i takon domethënies, pasi mund të shpjegohet edhe me mungesën e informacionit të prindërve për ekzistencën dhe funksionimin e këtyre organizmave (prindër që nuk janë të lidhur sa duhet me shkollën dhe nuk marrin pjesë në takimet kur zgjidhen këshillat e klases dhe shkollës) si dhe mënyrën e funksionimit të tyre, ku lidhjet me masën e prindërve nuk mbahen si duhet, dhe ata nuk informohen për veprimtaritë e kryera dhe vendimet e marra. Ajo që mund të thuhet gjithsesi, është se ky rezultat kërkon vëmendje.

Prindërit kanë gjithashtu opinion të përzierë për sa i përket *shpëstësisë dhe rregullsisë së funksionimit të këshillave të prindërve*. 36,4% pohojnë se ato funksionojnë shpesh (pra janë aktive) dhe 32% thonë se ato funksionojnë nganjëherë. Një element tjetër që është shqyrtuar është *mënyra e zgjedhjes së këshillave të prindërve*, ku shumica e prindërve 62,8%, pohojnë se këshilli është zgjedhur nga vete ata, 18,1 nga mësuesi kujdestar, 12,1 si vazhdim i këshillit të një viti me pare. Ekziston shqetësim për formalizmin në zgjedhjen dhe funksionimin e këshillave apo komiteteve të prindërve. Ata shprehin se “sipas kërkesave të mësuesve” mbledhjet e prindërve bëhen për disiplinën, mungesat e nxënësve, rezultatet në mësim, gjendjen arsimore të personelit mësimdhënës, etj. Një kryetare këshilli prindërisht deklaroi se “mësuesit nuk kanë nivelin e duhur arsimor e profesional dhe krijojnë probleme në marrdhëniet dhe komunikimin me prindërit”. Shprehet njëkohësisht mendimi se *këshilli i prindërve duhet të jetë më i pavarur*. Ndjehet hezitimi i prindërve për të marrë përsipër drejtimin e këshillave dhe për të qenë kritik ndaj shkollës, për të mos dëmtuar fëmijët e tyre. *Kjo frikë duhet adresuar sepse mund të jetë një nga pengesat reale më afatgjata për përfshirjen e prindërve në nivel shkollë*. Ka patur edhe raste ku pohohen përplasje të këshillit të prindërve me DAR dhe pushtetin vendor.

“Kjo është shkencë dhe në nuk e njohim mirë”. Ky vlerësim vetë-kritik është mjaft i dobishëm për të pranuar programe trajnimi për prindërit, për të rritur nivelin e njohurive dhe shprehive të tyre.”

Vetë prindërit konstatojnë se është indiferentizmi i tyre shkaku kryesor për përfshirjen e pamjaftueshme në shkollë. Pjesëmarrja më e madhe vjen kryesisht nga nënat, ndërkohë që nga baballarët indiferentizmi është më i theksuar. Por edhe mungesa e njohurive për t’u marrë me edukimin e fëmijëve është një nga shkaqet.

Një konstatim shumë i rëndësishëm lidhur me aspektet psikologjike të bashkëpunimit prindër-mësues është ai i nevojës për të pranuar mendimet e prindërve ashtu siç janë, e jo siç i duan mësuesit (e shprehur kjo nga një mësues).

Po kështu, kërkohet përgjegjësi e plotë nga prindërit që marrin pjesë në këshillat, para masës tjetër të prindërve. Sugjerohet *të ketë një mjedis të veçantë për prindërit dhe këshillat e tyre ku ata të mblidhen dhe të organizohen në shkollë dhe ku të ruajnë dokumentacionin e tyre*. Për sa i përket zgjedhjes së këshillave të prindërve, vihet re një prirej, ndoshta jombizotëruese për të përfshirë në to prindër “që kanë një farë biznesi”. Një pikëpamje interesante dhe me vlerë praktike është që **prindërit që**

“Edhe mungesa e traditës dhe përvojës së bashkëpunimit nga drejtuesit /mësuesit mund të kapërcehet vetëm kur prindërit shohin realisht dëshirë të sinqertë, përkushtim e drejtësi në ato që thuhet e bëhen në shkollë. Ata duan të shohin ndryshim real”.

aktivizohen dhe kontribuojnë në shkollë duhet të stimulohen duke u propaganduar dhe bërë të njohur në shkollë dhe komunitet.

Bordi i shkollës. Këtu 70,2% e prindërve përgjigjen pozitivisht kur pyeten nëse funksionon bordi i shkollës në shkollën tuaj, ndërsa 21,5 % përgjigjen “jo”. Pyetjes

nëse bordi përfaqëson interesat e tyre si prindër 61,3% i përgjigjen “po” dhe 21,5% “jo”. Lidhur me nivelin e informimit për diskutimet dhe vendimet e bordit, përgjigjet bëhen akoma më pak pozitive: përkatësisht: 47,9%-po dhe 40,4 % -jo. Përgjigja mund të mos tingëllojë befasuese nëse merret parasysh që bordi është një grup më i vogël dhe që ndodhet shumë pranë drejtorisë së shkollës dhe përfshin edhe përfaqësues të biznesit që mund të mos jenë fare prindër të fëmijëve të shkollës. Gjithsesi, duket që *bordi është më pak i lidhur me masën e prindërve se sa këshillat e prindërve të klasës e të shkollës.*

Funksionet që prindërit i bashkangjisin bordit të shkollës tani për tani (mënyra se si ata i njohin këto funksione) janë sipas rendit zbritës: kontrolli i ecurisë së procesit mësimor, mbledhja dhe administrimi i fondeve për shkollën, vendosja e disiplinës dhe rendit në shkollë, organizimi i aktiviteteve të ndryshme (kjo e konfirmuar nga intervistat, ka të bëjë me faktin se bordi siguron shpesh herë shpenzimet për këto aktivitete, kryesisht nëpërmjet prindërve biznesmenë, antarë të tij), ndihmon në mirëmbajtjen e shkollës dhe pajisjeve të saj, siguron bashkëpunimin me autoritetet e pushtetit vendor dhe komunitetin, etj. Bie në sy se prindërit e kanë pak a shumë të qartë që bordi ka një rol vendimmarrës në shkollë. Pyetja ka qenë e hapur dhe të gjitha funksionet e bordit janë formuluar dhe përcaktuar nga vetë prindërit sipas kuptimit që ata kanë për to.

Mendime të tjera interesante janë ato për rolin e bordit si lehtësues i marrëdhënieve mes mësuesve-prindërve dhe nxënësve, kontrollin e zbatimit të vendimeve të marra, zgjidhjen e konflikteve në shkollë, monitorimin e ndjekjes së shkollës nga nxënësit, etj.

Interesant është një funksion që prindërit e kanë përcaktuar në përgjigjet e tyre si: “monitoron respektimin e të drejtave të nxënësve dhe prindërve”.

Në të njëjtën kohë, bordit i njihet edhe një rol informues e këshillues, por pa bërë specifikime se për çfarë. **Ka edhe prindër, ndonëse në një përqindje të vogël, që mendojnë se bordi “ nuk ka asnjë rol ”.**


Përsa i takon rolit që prindërit do të dëshironin që të kishte bordi, të pyetur se “ çfarë detyrash e funksionesh mendoni që në të ardhmen duhet të shtohen”, ata rekomandojnë që: “te bëjë kërkesa për kushte më të mira brenda në shkollë dhe jashtë saj, kontroll financiar të pavarur të shkollës si dhe manaxhim të fondeve të saj, autonomi në vendimmarrje, kërkesa ndaj mësuesve dhe pushtetit vendor, monitorim të mbarëvajtjes së procesit mësimor, autoritet për zgjedhjen e drejtuesve të shkollës, e drejta për t’u ankuar me lart për problemet që ka klasa/shkolla”, etj.

Ndërsa përgjigjet për pyetjen se çfarë funksionesh duhet t'i hiqen bordit, janë me të paqarta. Gjithsesi, shumica pohojnë se nuk duhet t'i hiqet asnjë funksion dhe se bordi duhet të mos vazhdojë të jetë për inerci, bazuar mbi zgjedhjet e bëra një vit më parë. Reagimi i fundit është mjaft i rëndësishëm dhe do të trajtohet serisht më vonë, lidhur me nivelin e demokracisë dhe përfaqësimit në organet prindërore.

Ndërkohë, **drejtuesit e shkollave pohojnë se do të dëshironin të kishin një bord më të përfshirë në përzgjedhjen e mësuesve dhe të vet drejtuesve.** Shumica e drejtuesve të shkollave janë të hapur për një gjë të tillë si edhe për ndarjen e funksioneve të manaxhimit të fondeve të shkollës me bordin. Këtu bien në sy disa prirje të rëndësishme. E para, është *përzgjedhja e bordit*, ku sipas shumë drejtuesve, ata kanë një rol të rëndësishëm në përzgjedhjen e antarëve të tij. E dyta, ka të bëjë me vetë ekzistencën dhe funksionimin e bordit ku legjislacioni, të paktën ashtu siç kuptohet nga drejtuesit e shkollave, serisht e le në dorë të tyre vendimin për të patur bord në shkollë. Ata pranojnë se në fakt, bordi mblidhet kur e kërkon drejtori dhe në më të shumtën e rasteve për tematikat e caktuara nga ai/ajo.

Niveli i raportimit tek prindërit e tjerë është i dobët dhe po kështu transparencja për vendimet, gjë që ngrihet si shqetësuese nga shumë drejtues dhe prindër. Vihet re se shpesh bordi nënkuptohet si një mekanizëm mbrojtës për drejtorin, kur edhe në rastet që ai është i bindur se si drejtues po bën veprime të drejta (kryesisht për manaxhimin e fondeve) do të dëshironte të kishte dhe bordin në krah, si mbrojtje ndaj akuzave të mundshme. Neqoftëse është fjala për një përgjegjshmeri dhe llogaridhënie të përbashkët, kjo nuk do të kishte asgjë të keqe. Problemi krijohet në rastet kur bordi dhe drejtuesi i shkollës kanë marrëdhënie klientelizmi dhe bordi kthehet nga një organ mbrojtës i interesave të prindërve dhe të shkollës, në një mbulues dhe bashkëndarës i gabimeve të drejtuesit të shkollës.

Gjithashtu, konstatohet se **nga drejtuesit e shkollave, bordit i atribuohet si rol më i rëndësishëm ai i gjetjes së fondeve për shkollën.** Kjo është e kuptueshme në kushtet e fondeve të kufizuara, por nga ana tjetër rrezikon të krijojë një imazh krejtësisht të përmbysur përsa i përket rolit që duhet të luajnë në të vërtetë bordet.



Mjaft drejtues pohojnë se kanë gjetur për bordet e shkollave të tyre prindër biznesmenë, të cilët kanë zgjidhur disa probleme financiare për shkollën. Kjo në vijim ngre çështjen e rrezikut të intrumentalizimit të bordeve nga pikëpamje krejtësisht utilitare. Në përvojën e përparuar botërore, roli i përfaqësimit të biznesit në borde ka të bëjë me nevojën e shkollës për të pasqyruar në edukimin që siguron, nevojat e prodhuesve dhe të punëdhënësve lokalë, si dhe opinionet e komunitetit për formimin qytetar të fëmijëve dhe të të rinjve. Është

interesant, se nga vetë prindërit (antarë të shoqatave të prindërve të intervistuar) pohohet se bordet dhe komitetet e prindërve nuk funksionojnë si duhet e kthehen në “shtojca të drejtorit të shkollës për një manaxhim jo të mirë të fondeve”. Në të njëjtën kohë shprehet edhe mendimi se drejtorët janë barriera kryesore për funksionimin e tyre, pasi duan që të vendosin vetë për gjithshka.


Del e nevojshme të sqarohet rëndësia dhe arsyeja e përfshirjes së biznesit në bordin e shkollës, para se kuptimi që duket se ekziston aktualisht të kthehet në një përvojë mjaft të rrënjosur dhe që është vështirë të korigjohet. Shpesh ndodh që biznesmenët vertet të ndihmojnë shkollën materialisht e financiarisht, por ata mund të mos jenë njëerëz të më të përshtatshëm për të transmetuar, shprehur dhe mbrojur kërkesat dhe të drejtat e prindërve të tjerë apo masës së tyre. Ata mund të mos kenë as edhe kohën e duhur në dispozicion për të qenë aktivë në këtë drejtim. Për nga vetë natyra e punës së tyre mund të jenë të prirur të shikojnë ndihmesën financiare si më të rëndësishme se të tjerat. Ndoshta një kombinim i cilësive të një prindi si biznesmen me atë të përfaqësimit të prindërve të tjerë do të ishte më i pranueshëm si fillim i ndryshimit të kësaj praktike të deritanishme.

Vihet re edhe një prirje intelektualiste lidhur me përbërjen e këshillave të prindërve dhe bordeve, ku sipas disa të intervistuarve duhet të zgjidhen prindër intelektualë pasi prindërit pa shkollë “nuk mund të vlerësojnë dot mësuesit”. Kjo pikëpamje, në rast se zë vend gjerësisht, paraqet problem për anën përfaqësuese të këshillave dhe bordeve, sidomos në shkollat e fshatrave dhe mund të përjashtojë nga këto organizma prindërore shumë prindër që mund të mos jenë intelektualë nga profesioni i tyre, por mund të jenë mjaft të interesuar, aktivë si dhe bashkëpunues dhe të respektuar nga prindërit e tjerë. Vlen të theksohet se duhet të krijohet bindja që pjesëmarrja prindërore nuk duhet të jetë aspak përjashtuese por, demokratike dhe sa më e hapur për këdo.

Një problem që kërkon zgjidhje për shkollat e vogla, kryesisht në zonat fshatare është ai i krijimit të një bordi të përbashkët për disa shkolla sëbashku. Ndonëse një bord i tillë do të kishte anë pozitive atë të mbulimit të një komuniteti më të madh dhe të mundësisë për të bërë krahasime mes shkollave për punën e tyre, ana e tij negative do të ishte heterogjeniteti në pjesëmarrje dhe ndoshta një ndjenjë më e dobët përkatësie e prindërve pjesëmarrës. Në kete rast do të ishte me mirë që shkollat që kanë të njëjtin bord, t’i përkasin cikleve në vijim se sa të njëjtit cikël, psh shkollë 9-vjeçare dhe e mesme sesa disa shkolla 9-vjeçare. Kjo për arsyen se do të krijohej një vazhdimësi e përfaqësimit të prindërve dhe e interesimit të tyre kur fëmijët kalojnë nga një cikël shkollor tek një më i lartë. Megjithatë, nevojiten më shumë hulumtime dhe eksperimentime në këtë drejtim.



Krahas pranimit që ekziston për përfshirjen e prindërve në përzgjedhjen dhe emërimin e personelit mësimor dhe drejtuesve të shkollave, mendimet janë që në këtë fushë duhet të ecet me kujdes dhe opinionet e prindërve të merren parasysh, por në formë këshille dhe jo vendimi. Argumenti është që: *nxënësit janë vlerësuesit e parë dhe më të drejtpërdrejtë të cilësisë së mësimin dhe ata ua transmetojnë këtë informacion prindërve*. Prandaj, në emër të fëmijëve të tyre, prindërit duhet të kenë të drejtën të shprehin opinione për ta. Megjithatë, përzgjedhja e mësuesve nuk mund të lihet tërësisht në dorën e prindërve, pasi ata nuk kanë formimin dhe njohuritë e duhura për të bërë një vlerim tërësisht objektiv dhe profesional. Përmenden raste kur prindërit kanë ardhur në shkollë me kërkesa të pajustificueshme dhe me agresivitet, pa njohur mirë dhe pa respektuar rregulloren dhe kërkesat e shkollës dhe detyrat e tyre si prindër, dhe është dashur mjaft mund për të normalizuar situatën.



Njëkohësisht, lidhur me vështirësinë në luajtjen e rolit të prindërve në emërimin e drejtuesve të shkollës dhe e mësuesve si dhe në zgjidhjen e problemeve, përmendet edhe *ndikimi negativ i ndërhyrjeve të politikes, kryesisht asaj lokale*. Kjo është një çështje që duhet të mbahet parasysh, neqoftëse do të programohet një vendimarrje më e madhe e prindërve.

Ka mendime që *bordet duhet të vendosen jashtë shkollës dhe pranë bashkisë, komunës, ose DAR, për të shmangur ndikimin apo manipulimin nga drejtuesit e shkollës dhe për të qenë më të pavarur,*

por njëkohësisht më afër organeve drejtuese arsimore, gjë që ndihmon në zgjidhjen e problemeve. Një variant tjetër i kësaj ideje është që *DAR të ketë një bord këshillues për arsimin e aty të ketë edhe përfaqësues nga shoqatat e prindërve*. Një sugjerim tjetër, (i dalë nga punonjësit socialë të shkollave), është që *bordet të bashkëpunojnë më shumë me median për prezantimin e arritjeve dhe mangësive që mund të ketë shkolla dhe për të ushtruar trysni mbi organet vendore dhe ato arsimore*. Kjo do të forconte rolin dhe do të rriste vlerësimin për to nga vetë prindërit dhe komuniteti.

Shoqatat e prindërve shfaqen si pika më e dobët e organizimit dhe përfaqësimit prindëror. Vetëm 22 % e prindërve përgjigjen se ekzistojnë shoqata prindërisht në zonën e tyre, ndërsa 66,5% përgjigjen negativisht. Edhe në këtë rast pyetja është bërë që të përmbliidhen të gjitha shoqatat e mundshme, pa specifikuar në nivel klase, shkolle, rrethi apo qarku. Pra, përgjigjja negative do të thotë se nuk është e pranishme asnjë lloj shoqate, e çfarëdo niveli qoftë. Akoma me domethënëse është përgjigjja e prindërve ndaj pyetjes nëse ata vete marrin pjesë në shoqatë prindërisht. Vetëm 7,6 % kanë pohuar një gjë të tillë. Bie në sy fakti se në këtë pyetje **ka një numër shumë të madh mospërgjigjesh, që mund të jetë pasqyrim i mosnjohjes së shoqatave nga ana e prindërve**.

Vihet re se edhe shoqatat ekzistuese të prindërve janë mjaft lokale dhe të dobëta, në sensin që pak ndihet zëri i tyre dhe nuk ka ndonjë çështje madhore që është ngritur nga ato në organet e larta arsimore. Shoqatat e prindërve çalojnë shumë nga pikëpamja e qendrueshmërisë financiare. Shumica e tyre ekzistojnë dhe veprojnë kur ka fonde donatorësh dhe janë të bashkangjitura tek ata. Sapo donatorët largohen edhe shoqatat e shuajnë veprimtarinë e tyre pa lënë pas ndonjë gjë mbresëlënëse. Edhe projektet që janë zhvilluar me ndihmën e donatorëve janë projekte të vogla (mini-projekte), që nuk ndihmojnë sa duhet në rritjen e popullaritetit të shoqatës në një masë të madhe prindërisht dhe në publikun në përgjithësi. Kjo nuk i jep mundësi shoqatës të kryejë veprimtari të rëndësishme (ndonëse më të veshtira) si psh. për të ndikuar në vendimet e DAR, ose MASH, etj , të cilat do t'u rrisnin respektin dhe njohjen nga masa e prindërve, dhe do të nxisnin gatishmërinë e tyre për të kontribuar financiarisht. Njëkohësisht, do të ishte *pikënisja e vërtetë e krijimit të një shoqate kombëtare prindërisht sipas modelit nga poshtë-lart*. Fakti i pamjaftueshmërisë financiare të shoqatave të prindërve pasqyron në një masë të madhe faktin që ato kanë qenë kryesisht krijesa donatorësh dhe kanë antarësi fare të kufizuar. Edhe mënyra e funksionimit, pa strukturat demokratike që duhen për marrjen e vendimeve dhe raportimin tek antaret, mund të luajë rol në gjendjen e tyre të përgjithshme të dobësisë institucionale.

Psh., një nga çështjet që bordi ka zgjidhur me DAR ka qenë riparimi i palestrës që ishte në rrezik të shëmbej duke rrezikuar jetën e fëmijëve. Kjo u bë duke marrë vendim unanim që mësimi në palester të ndërpritej derisa bashkia të investonte për riparimin. Ndërsa, problemi që nuk u zgjidh dot, ishte se nuk mbrojt dot stafin mësimor për të mos lëvizur nga shkolla, ku erdhen 20 mësues të rinj e pa përvojë, dhe u larguan shumë mësues me përvojë.

Por ajo që tingëllon më shqetësuese është *psikologjia e vartësisë nga donatorët*, kur vetë kryetarë shoqatash prindërisht pohojnë se problemi i tyre kryesor është “pakësimi i donatoreve” apo largimi i tyre. Megjithatë, ka edhe raste mjaft pozitive si në Kukës ku shoqata e prindërve pohon se *ka marrë fonde nga DAR dhe bashkia për të kryer veprimtari të përbashkëta*. Ndonëse fondet në të vërtetë mund të jenë të vogla, e rëndësishme është *prania e klimës së besimit reciprok dhe bashkëpunimit*. Ky është një shëmbull që ia vlen të eksplorohet me tej pasi mund të përbëjë një model të zbatueshëm edhe në qarqe të tjera.

Problemet e përmendura më sipër kanë sjellë si rezultat mungesën e një shoqate kombëtare të vërtetë prindërisht, në kuptimin e një organizate gjithëmbuluese dhe përfshirëse, që të ketë veprimtari në rang kombëtar dhe që të njihet nga masa e prindërve si një përçuese e zërit të tyre. Ka shoqata prindërisht që pretendojnë se bëjnë pjesë në “Konfederatën e prindërve”, por kjo ngelet për t'u parë me tej. Përvoja e deritanishme ka treguar se këto lloj shoqatash prindërore të nivelit kombëtar janë krijuar nga lart dhe me ndihmën e donatorëve, por nuk kanë qenë në gjendje të zbresin poshtë dhe të depërtojnë në masën e prindërve. Të qenit kombëtar, është diçka që mbetet vetëm në emrin e tyre, por pak pasqyron shtrirjen e vërtetë.

Mund të thuhet se deri tani MASH-it i mungon një partner kombëtar që përfaqëson prindërit në diskutimet dhe vendimmarrjen e arsimit. Nëqoftëse kjo gjendje zgjat, rrezikon të lerë në nivel të ulët demokratizimin dhe përmirësimin e arsimit, në favor të interesave të fëmijëve. Rreziku tjetër është që në mungese të një shoqate të tillë kombëtare me antarësi të madhe dhe aktive, prindërit të përfaqësohen nga pseudo-shoqata që përbëhen vetëm nga grupe të vogla individësh që nuk i japin llogari askujt dhe që nuk mund të mobilizojnë prindërit për të ushtruar ndikimin e tyre në mënyrë të organizuar.

Ne këto kushte, ndikimi prindëror mund të ushtrohet vetëm mbi baza shkolle dhe në mënyrë të fragmentuar, në zgjidhje të problemeve lokale. Këto sigurisht janë shumë të rëndësishme dhe të prekshme për prindërit, por ka edhe probleme më madhore që prekin çdo fëmijë dhe prind dhe që mund të zgjidhen nga një zë i bashkuar i prindërve. Megjithatë, ndoshta rruga e natyrshme do të ishte ajo e forcimit fillimisht të shoqatave lokale e mbi bazë shkolle dhe mbi bazën e suksesit të punës së tyre të kalohej në ngritjen graduale të një shoqate kombëtare prindërisht. Këtu **do të ishte me shumë rëndësi mesazhi i transmetuar nga MASH, lidhur me gatishmërinë e saj për të negociuar për çështje të rëndësishme të arsimit me shoqatën kombëtare të prindërve**. Sigurisht që krijimi dhe funksionimi i një shoqate të tillë duhet të jetë krejtësisht nismë e prindërve, por hapja e MASH ndaj shoqatave të tilla do të forconte besimin e prindërve se një organ i tillë mund të sjellë ndryshime. Aktualisht prindërit nuk kanë besim se problemet që shtrojnë mund të zgjidhen. Shumë mësues përmendin faktin se prindërit interesohen më shumë për probleme individuale të fëmijës së tyre, se sa për probleme më të përgjithshme të klasës/shkollës e të të gjithë fëmijëve. Ky lloj individualizmi mund të jetë zanafilla psikologjike e mosorganizimit në organet e ndryshme prindërore, e sidomos në shoqatat.

Ka shumë nevojë për ndërgjegjësimin e prindërve për rolin e tyre jo vetëm në shkollë por për të gjitha vendimet e rëndësishme që kanë të bëjnë me edukimin e fëmijëve të tyre. Shumë mësues, por edhe vetë prindër, pohojnë se shumica e përgjegjësisë për edukimin e fëmijëve u delegohet tërësisht shkollës dhe mësuesve, duke kufizuar detyrimin e vetë prindërve vetëm në krijimin e kushteve të domosdoshme të të nxënit për fëmijën (strehim, ushqim, veshmbathje). E kombinuar me ndjenjën e inferioritetit ndaj mësuesve, kjo mund të kthehet në pengesën kryesore të bashkëpunimit shkollë-familje. Pozitiv është fakti që drejtues shkollash propozojnë se duhet të organizohen veprimtari kualifikuese dhe trajnuese me prindërit e tyre. Nga ana tjetër, një nga problemet që theksohen nga vetë shoqatat e prindërve është prirja e drejtuesve dhe e institucioneve shtetërore "për të mos ndarë pushtetin me shoqërinë civile" dhe me partnerët e shkollës.

Ajo çfarë marrin përsipër disa shoqata prindërisht është fuqizimi i këshillave të prindërve dhe bordeve të shkollave. Kjo duket një nismë që duhet përkrahur, pasi shoqatat të cilat mund të kenë më shumë vite aktiviteti dhe më shumë përvojë të grumbulluar, mund ta përdorin këtë me efikasitet për të aftësuar këshillat dhe bordet në funksionimin e tyre. Kjo do të krijonte edhe një rrjet organesh prindërore që këmbëjnë ide dhe veprojnë sëbashku, ndoshta deri në krijimin e shoqatës kombëtare

të prindërve në mënyrë demokratike dhe të pavarur nga donatorët. Shoqatat shohin si një mundësi të tyre edhe **sensibilizimin e masës së prindërve për të marrë pjesë aktive në edukimin e fëmijëve në shtëpi dhe në shkollë.**

Kanalet e komunikimit të qendrimit të prindërve ndaj politikave arsimore e vendimeve të MASH, të cilat prindërit pohojnë se përdorin më shpesh janë sipas rendit zbritës: drejtoria e shkollës ku mëson fëmija, bordi i shkollës, komiteti ose këshilli i prindërve të shkollës, DAR, mjetet e informimit publik, shoqata e prindërve, letra dërguar drejtpërdrejtë MASH, komuna ose bashkia përkatëse, organizatat jo-qeveritare. Duket mjaft e arsyeshme që prindërit të përdorin në radhe të parë drejtorinë e shkollës si kanal komunikimi të qendrimeve të tyre, për vetë faktin se kjo është më e afërta por edhe ajo me të cilën ekzistojnë lidhje me të ngushta.

Duket sikur ka një farë mospërputhje mes faktit që bordit të shkollës i atribuohet një rol i lartë, me pohimin e përmendur më parë, që vendimet e bordit nuk para njihen. Nga ana tjetër, siç rezultoi nga intervistat, bordi është një organ që nuk përdoret dhe nuk thirret shpesh por, kryesisht për probleme të rëndësishme që duan zgjidhje. Kjo mund të shpjegojë besimin e prindërve tek roli i bordit kur vjen fjala për vendime dhe çështje të tilla të rëndësishme dhe mjaft të prekshme. Përgjigjja tërheq vëmendjen në faktin që **bordi paraqet një potencial të lartë të përfaqësimit të prindërve për çështje madhore** dhe domethënëse dhe se *sëbashku dhe në kombinim me drejtorinë e shkollës dhe komitetin/këshillin e prindërve, do të përbënin hallkën e parë të komunikimit mes organeve politikbërëse e vendimmarrëse me shkollat, duke i parë këto si entitete që përfshijnë prindërit, mësuesit dhe nxënësit.*

Idetë dhe sugjerimet që kanë vetë prindërit lidhur me përmirësimin e bashkëpunimit me shkollat dhe që kanë të bëjnë me organe si këshillat e prindërve dhe bordet janë që:

- Zgjedhjet e tyre të mos jenë formale, “vetëm për të plotësuar letrat” por për t’i ardhur në ndihmë problemeve të shkollës.
- Personave që zgjidhen në to si përfaqësues të prindërve, t’u bëhet e qartë detyra që kanë dhe në rast se nuk mbajnë përgjegjësitë që u takojnë, të shkarkohen.
- T’i jepet përparësi komitetit të prindërve për të siguruar kontaktin me prindërit që kanë fëmijë me probleme.
- Shkollat të zgjerojnë llojshmërinë e problemeve që duhet të diskutojnë me prindërit, jashtë skematizmit të tanishëm, i cili përqendrohet vetëm tek notat.
- Bordi i shkollës të paraqesë ankesat para drejtorisë së shkollës, dhe kjo e fundit para DAR e organeve vendore.
- Bordi i prindërve të ketë antarë nga çdo klasë në mënyrë që të bëhen të njohura problemet e të gjitha klasave.
- Të ndryshohet legjislacioni për t’u dhënë më shumë fuqi bordeve të shkollave dhe shoqatave të prindërve, dhe komiteti i prindërve të ketë të drejtë propozimi për emërimin dhe largimin e personelit mësues.

- Përfaqësim i drejtpërdrejtë i bordit nëpërmjet një antari të tij në organet arsimore.
- Problemet e shkollës të merren në dorë nga një bord i përbërë nga mësues, prindër dhe nxënës.
- Te vlerësohen shkolla dhe mësuesit edhe nga niveli i bashkëpunimit me organet prindërore.


2. Mësuesit

48,3% e tyre i përkasin shkollave të qytetit dhe shpërndarja sipas ciklit shkollor është: cikli i ulët 29,5%, cikli i lartë 48,3 % dhe shkollat e mesme 19,9%. Njëkohësisht, numri i viteve të punës varion me shpeshtësinë më të madhe (6,8%) për 20 vjet punë si mësues, e më pas (6,3%) 12 vjet, 5,7% me 30 vjet, 5,1% me 7 vjet, dhe vetëm 4,5% me 3 vjet. 73,9% janë me arsim universitar dhe vetëm 2,3% me arsim të mesëm të përgjithshëm ose profesional (jo pedagogjik). 3,4% kanë arsim jo të lartë dhe të mesëm që nënkupon mësues me arsim të kufizuar e të pamjaftueshëm për punën e tyre.

Shumica e tyre (51,1%) përgjigjen se janë “pak a shumë” të kënaqur me marrëdhëniet që kanë krijuar me prindërit e nxënësve të tyre. 13,6% përgjigjen se janë plotësisht të kënaqur, 4,5% janë pak të kënaqur, dhe vetëm 0,6% aspak të kënaqur.

Ajo që ata *kërkojnë me shumë nga prindërit* është (në rend zbritës): kontrolli i të nxënësve në shtëpi, informacion mbi personalitetin e fëmijës, ndihmë për detyrat e shtëpisë dhe njohuritë e tyre lëndore të specializuara. Mësuesit e ndjejnë veten përgjithësisht të përgatitur mirë nga formimi i tyre fillestar për lidhjen dhe bashkëpunimin me prindërit. Vetëm 4% e tyre e ndjejnë veten aspak të përgatitur dhe 11,9% pak të përgatitur. Nuk është bërë dot lidhja gjatë studimit nëse mësuesit që janë përgjigjur në këtë mënyrë janë ata me arsim të pamjaftueshëm ose pa atë përkatës. Gjithsesi, përgjigjja tingëllon disi optimiste.

Lidhur me *ndihmën që u jep drejtorja e shkollës përsa i përket bashkëpunimit me prindërit*, 43,8% e tyre pohojnë se ndihmohen shumë, 37,5% mjaftueshëm dhe 8,5% dhe 4,5% përkatësisht pak dhe aspak. Shumica dërrmuese pohojnë se bashkëpunimi me prindërit merret parasysh nga drejtorja e shkollës në vlersimin e tyre si mësues. 90,9% e tyre kërkojnë ndihmë dhe sugjerime nga kolegët për të zgjidhur problemet në marrëdhëniet me prindërit. Shqetësues është fakti se 71% e mësuesve përgjigjen se nuk kanë marrë trajnime për punën me prindërit dhe për ata që janë trajnuar, 13,1% thonë se i kanë marrë trajnimet



nga drejtoria e shkollës (që konfirmon përgjigjen e mëparshme se ndihmohen dhe vlersohen nga drejtoria e shkollës në këtë drejtim) dhe 7,4% nga OJQ-të e ndryshme. Bie në sy se në këtë pyetje ka një numër shumë të madh mospërgjigjesh, dhe përqindjet e mësipërme, ndonëse mund të duken të ulta në vlera, janë me të lartat ndërmjet përgjigjeve. Lidhur me sa respektohen dhe dëgjohen prindërit në shkollat tona, 51,7% e mësuesve mendojnë se ata respektohen shumë dhe 38,6% disi, ndërsa 7,4% pak dhe 0,6% aspak. Kjo tregon se gjendja le ende për të dëshiruar.

Lidhur me vështirësitë e tyre për punën me prindërit, mësuesit rendisin (në rend zbritës):

- Mungesa e interesit nga prindërit dhe mosardhja e tyre në shkollë dhe në takimet me prindër
- Niveli i ulët arsimor i prindërve
- Problemet dhe vështirësitë ekonomike e sociale të prindërve
- Delegimi i përgjegjësisë për edukimin e fëmijëve nga prindërit vetëm tek shkolla
- Interesimi nga prindërit vetëm për disa aspekte të punës së shkollës dhe kërkesa për rezultate të larta, jo të merituar, nga fëmijët e tyre.
- Mungesa e mirëkuptimit mes mësuesve dhe prindërve
- Mosvleresimi sa duhet nga prindërit i punës së shkollës
- Sjellja dhe moskomunikimi nga ana e prindërve
- Mosnjohja e termave dhe aspekteve të reja nga prindërit në programet arsimore që kanë ndryshuar mjaft
- Mosnjohja nga prindërit e personalitetit të fëmijës së tyre.
- Largësia e vendbanimit nga shkolla
- Mbingarkesa e mësuesve

Bien në sy dy fakte interesante: ***mësuesit shohin gjithë arsyet dhe problemet në anën e prindërve dhe pothuajse asgjë në anën e tyre, dhe vetëm një pjesë e vogël përmendin si problem për veten, mbingarkesën.***

Si barriera renditen (në zbritje):


- Niveli i ulët arsimor i prindërve
- Mbingarkesa e prindërve me angazhime të tjera dhe punë
- Arritjet e dobëta mësimore të fëmijës
- Paaftësia e disa mësuesve për të krijuar marrdhënie të mira me prindërit

Ndonëse jo shumë të shpeshta, janë interesante disa nga përgjigjet si: ndroja e prindërve për të ndërhyre në çështjet e shkollës, si dhe fakti se prindërit pranojnë me vështirësi problemin ose të metat e fëmijës.

Përsa u përket përfitimeve që do të kishin nga përfshirja më e madhe e prindërve, renditen në mënyrë të permledhur: për *mësuesit*:

qetësi dhe rend në klasë dhe në shkollë, rendiment me të lartë të punës së tyre, qetësi në punë

Çfarë kërkoni më shumë nga prindërit?



dhe uljen e nivelit të stresit, rezultate me të larta për nxënësit dhe për vetë mësuesit, njohje më të mirë të nxënësve të tyre; për *shkollat*: njohje dhe respektim me i madh i punës dhe rolit të tyre nga shoqëria duke filluar nëpërmjet prindërve, mundësi për t'u thelluar në punë me nxënësit me vështirësi dhe prapambetje, por edhe ata të talentuar, investime dhe ndihma më të mëdha materiale e financiare nga prindërit dhe komuniteti; për *nxënësit*: rezultate me të larta në mësim, rritje të vetbesimit, çlirim nga stresi i fshehtësë së rezultateve dhe marrjes së mesazheve të kundërta nga shkolla dhe prindërit, edukimi me pjesëmarrjen

demokratike dhe vlerat qytetare të së vërtetës, guximit, etj., marrdhënie më të ngrohta me mësuesit, shtimin e dashurisë për shkollën: për *prindërit*: më shumë përfshirje në vendimmarrje, bashkëpunim komunitar me familje të tjera, ndihmë ndaj shkollës për të kuptuar dhe njohur më mirë probleme të veçanta të fëmijës, informim me të mirë për gjithshka ndodh në shkollë dhe me fëmijën e tyre si dhe të mjedisit shoqëror të fëmijës, mundësi reagimi të shpejtë ndaj çdo problemi, mundësi për të ndihmuar dhe vlerësuar më shumë shkollën dhe fëmijën e tyre.

“Nxënësit do të ishin përfituesit më të mëdhenj të bashkëpunimit, sepse do të ndjenin më nga afër vlerën e të qenit të përgjegjshëm dhe të vlerësuar, nën trysinë e dashurisë dhe disiplinës”

Ato çfarë propozojnë mësuesit për të rritur bashkëpunimin me prindërit janë:

- Trajnime për prindër për rolin e prindit si edukues, trajnime për mësues si dhe trajnime të përbashkëta për të dy palët
- Literaturë për këto probleme si për mësuesit edhe për prindërit
- Rekomandim modelesh dhe përvojash të mira të punës me prindërit
- Marrje të nismave nga vetë prindërit, pa pritur nga shkolla
- Bashkëpunim me psikologët dhe punonjësit socialë të shkollave
- Shkëmbim përvojë mes këshillave të prindërve
- Njohjen e prindërve me planin edukativ të shkollës që ata të përfshihen në zbatimin e tij
- Motivim i mësuesve që bashkëpunojnë me sukses me prindërit
- Përfshirja e prindërve në hartimin e planeve dhe strategjive të shkollave
- Shkolla t'i bëjë prindërit të ndjehen të mirëseardhur dhe të respektuar
- Hartimi i politikave të tilla që lejojnë një pjesëmarrje më të madhe të prindërve për të siguruar partneritet
- Të sensibilizohen prindërit dhe opinioni publik nëpërmjet ciklesh emisionesh radio dhe televizive
- Hartimi i një marrveshjeje për bashkëpunim
- Krijimi i organizatave trajnuese për problemet e bashkëpunimit shkollë-familje

- Mësuesit të bëjnë vizita në shtëpitë e prindërve indiferentë
- Të krijohet salla e prindërve në shkolla
- Përmirësim legjislativ që rregullon bashkëpunimin dhe përfshirjen e prindërve

Mësuesit kanë dhënë disa ide, ndonëse jo dhe aq konkrete, edhe përsa u takon trajnimeve që u nevojiten për aftësimin e tyre për bashkëpunimin me prindërit dhe komunitetin:

- Trajnime se si të punohet me prindërit që kanë fëmijë me probleme si drogë, alkool, duhan, etj.
- Trajnime në fushën e psikologjisë
- Trajnim për aftësi komunikimi
- Shkëmbim përvojë me shkollat e tjera dhe përvojë perëndimore
- Trajnim për psikologjinë e fëmijës dhe marrdhëniet e tij me prindërit
- Marrëdhëniet ndërpersonale

3. Psikologët dhe punonjësit socialë të shkollave

Një potencial i pashfrytëzuar për të ndërtuar apo përmirësuar marrdhëniet e shkollës me prindërit e fëmijëve që kanë më shumë probleme janë psikologët dhe punonjësit socialë të shkollave. Ata pritet që të kenë më shumë njohuri se mësuesit në disa drejtime, që do të ishin shumë të dobishme për të dyja palët: mësuesit dhe prindërit. Psikologët mund të bëjnë një analizë më objektive të problemeve në sjellje dhe në të nxënë të nxënësve të veçantë dhe të ndërtojnë bashkë me mësuesit alternativa dhe programe të veçanta ndihme, ku prindërit dhe mësuesit të marrin përsipër në mënyrë reciproke përgjegjësitë që u takojnë.

Nga intervistat me këtë kategori punonjësish të arsimit, ***vihet re interesi mi i tyre për të qenë të dobishëm dhe për të gjetur një pozicion të përshtatshëm në shkolla***, krahas mësuesve. Mjaft prej tyre kanë njohuri mbi nivelin e bashkëpunimit me prindërit në shkollën e tyre, ndonëse shumica shprehen që ky bashkëpunim nuk është optimal. Një punonjëse sociale psh përmend si rast të suksesit të trysnisë se ushtruar nga prindërit atë të zgjedhjes së gjuhës së huaj që do të mësohej në një shkollë 9-vjeçare nga prindërit, kur më parë kjo imponohej nga DAR. "Tani prindërit kanë ngulur këmbë që të zbatohet dëshira e fëmijëve".

Psikologët dhe punonjësit socialë gjithashtu ***këshillojnë përdorimin e fletoreve të komunikimit mes mësuesve dhe prindërve***, ku prindërit të bëjnë shenime në formën e mesazhit për mësuesin lidhur me shqetësimet që ka fëmija, përpjekjet e tij, si edhe të kërkojnë këshilla nga mësuesi për tejkalimin e problemeve".

Mund të shtohet se në shumë raste mund të jetë prindi që t'i japë këshilla dhe sugjerime mësuesit për mënyrën se si duhet trajtuar fëmija dhe se çfarë metodash mësimi zenë më shumë vend tek ai.

Nga DAR e Elbasanit, sivjet është futur në përdorim librezat e nxënësit, për të rritur intensitetin e

Por psikologët ndjejnë se “në përgjithësi prindërit nuk janë përfshirë në një ndihmë konkrete për të përmirësuar arritjet e fëmijëve”.

komunikimit me prindërit. Kjo është një përvojë e re që duhet të ndiqet dhe të vlersohet se sa perqafohet dhe zbatohet vërtet nga shkollat, dhe sa e ndryshon komunikimin mes mësuesve dhe prindërve.

Psikologët e shkollave mund të bëjnë trajnime për mësues dhe prindër lidhur me: shëndetin mendor të fëmijëve dhe të të rinjve, vështirësitë në të nxënë, etj.

Ndërkohë, shkollat mund të përmirësojnë dhe të shtojnë informacionin për prindërit lidhur me: programet mësimore, organet e shkollës, rregulloren, detyrimet e prindërve si dhe sukseset e shkollës. Ato mund të hartojnë një fletë informacioni për prindërit mbi: turnet e mësimin në shkollë, numrin e nxënësve për klasë, gjendjen e pajisjeve mësimore, nivelin e mësuesve dhe vitet e përvojës së tyre, etj, si edhe të kërkojnë bashkëpunimin ose mendimin e tyre për përmirësimin e gjendjes. Ata pohojnë se sipas tyre, mësuesit nuk kanë marrë njohuritë dhe aftësitë e duhura nga fakultetet për bashkëpunimin me prindërit, dhe se në planet e drejtuesve të shkollave ka pak veprimtari për këtë me mësuesit.

Sipas pikëpamjes së tyre, mësuesit nuk janë ende të gatshëm të marrin pjesë në trajnimet e ofruara nga psikologët dhe punonjësit socialë të shkollave. Arsyeja është një lloj mosbesimi dhe nënvleftesimi i temave të tilla të trajnimit që kanë të bëjnë me punën me prindërit. Është i pranishëm një fare rivaliteti dhe xhelozie profesionale si edhe nënvleftesim i aftësive të psikologëve. Një nga faktorët për këtë është edhe mosha e tyre e re, duke qenë një kontigjent që nuk ka shumë që ka dalë nga bankat e universitetit dhe që jo para shumë kohësh mund të kenë qenë vetë nxënësit e mësuesve të sotëm. Ata nuk shihen si një “urë lidhëse mes nxënësit-mësuesit dhe prindit”. Edhe në bisedat me grupin e punës së studimit, rezulton se drejtuesit e shkollave nuk kanë patur përvojë pozitive përsa i përket aftësive në punë të psikologëve dhe mendojnë se në përgjithësi mësuesit, sidomos ata me mjaft vite përvojë, janë më të përgatitur edhe në aspektet psikologjike se sa vetë psikologët. Mendohet se kjo vjen si rezultat i mangësive të formimit të tyre fillestar, dhe se ky i fundit duhet të avancohet shumë më tepër nëqoftëse pretendohet që psikologët dhe punonjësit socialë të bëhen një ndihmë e kualifikuar për shkollën.

Gjithashtu, ata kanë pak kontakte edhe me këshillat e prindërve dhe bordin e shkollës, pasi ky i fundit sipas tyre preokupohet më shumë për problemet financiare. Ata venë në dukje, se edhe nga prindërit mungon ndërgjegjësimi për rolin e tyre, dhe shumë pak kontaktohen nga ata, edhe gjatë takimeve me prindër që organizon shkolla. Sipas tyre, prindërit në përgjithësi interesohen më shumë për arritjet në mësimet e fëmijëve të tyre, sesa për sjelljen dhe qendrimin.

Ne fakt, vlen të përmendet se roli i psikologëve dhe punonjësve socialë mund të përqendrohet si në problemet e të nxënësve (që lidhen me rezultatet në mësimet) po ashtu edhe me ato të sjelljes, dhe që shpesh janë të lidhura me njëra-tjetren. Ata konstatojnë në vijim se shumë prindër nuk janë të hapur për të folur me ta për problemet shpirtërore dhe emocionale të fëmijëve të tyre, “per të mos u

hapur namin e keq". Psikologët pohojnë se në rastet që ata trajtojnë bëjnë pjesë edhe problemet e komunikimit të mësuesve me prindërit.


Një nga idetë që haset shpesh dhe e sugjeruar edhe nga punonjësit socialë është që çdo prind duhet të japë kontaktet e veta në shkollë si numrin e telefonit, adresën, vendin ku punon, dhe shkolla ta ketë përherë këtë informacion për t'iu drejtuar prindërve individualisht, sa herë të jete e nevojshme.

4. Drejtuesit e shkollave

56,8% e drejtuesve të intervistuar nëpërmjet pyetesorit u përkasin shkollave 9-vjeçare. Bie në sy se përqindjen më të madhe të tyre e përbëjnë ata që kanë 1 vit përvojë si drejtues shkolle dhe pastaj ata 8 dhe 17 vjet, e me pas 10 dhe 15 vjet. Gjysma e tyre përgjigjen se bordi në shkollën e tyre funksionon mirë, ndërsa shumica se do dëshironin që ai të marrë më shumë kompetenca. Lidhur me atë çka është thënë me lart mbi rolin mbizotërues të drejtorit të shkollës në formimin dhe funksionimin e bordit, del pyetja nese drejtuesit e shkollave duan më shumë kompetenca për një bord që e kanë nën kontroll apo edhe për një bord krejtësisht të pavarur dhe jashtë kontrollit të tyre? Ndërkohë, shumica e tyre mendojnë se mësuesit janë vetëm pjesërisht të përgatitur për të ndërtuar një bashkëpunim aktiv me prindërit. 81% pohojnë se në shkollën e tyre nuk ka ndonjë shoqatë prindërisht gje që konfirmon të dhënat e nxjerra për shoqatat nga burimet e tjera. Një përgjigje mjaft pozitive tingëllon ajo për njohjen me përvojat e përparuara perendimore për përfshirjen e prindërve, ku 59,1% e tyre shprehen se kanë marrë përvoja të tilla.

Drejtimit ku ata ndjejnë më nga afer ndihmesen e prindërve janë: kushtet dhe pajisjet e shkollës, vijueshmëria në shkollë dhe mbarë vajtja e fëmijëve, frekuentimi, disiplina dhe veprimtaritë kulturore. Ndërsa, si sferat më të vështira të bashkëpunimit përmend in: neglizhencen e prindërve dhe lënien në dore të shkollës të gjithshkaje, trysninë për rritjen e rezultateve të fëmijës si dhe mosdhënien e ndihmes financiare.

Përgjigjet e të dyja pyetjeve konfirmojnë edhe një herë rëndësinë që i jepet anës financiare dhe materiale në bashkëpunimin me prindërit.




Një vërejtje interesante lidhur me vështirësitë në funksionimin e bordit të shkollës është ajo e mungesës së përvojës për një organizëm të tillë si dhe mosnjohjen sa duhet nga prindërit të Dispozitave Normative.

Edhe për drejtuesit e shkollave ajo që pengon me shumë bashkëpunimin është:

- Papërgjegjshmëria dhe indiferenca e prindërve,
- Indiferenca e mësuesve dhe mungesa e interesimit nga ana e tyre për bashkëpunim me prindërit,
- Përvoja dhe kualifikimi i pakët i mësuesve,
- Ngarkesa e lartë mësimore e mësuesve,
- Mosvlerësimi dhe mosshpërblimi i punës me prindërit
- Kushtet e shkollës dhe largësia e saj nga vendbanimi
- Problemet ekonomike dhe niveli arsimor i prindërve

Interesantja në përgjigjet e tyre është se ndërkohë që konfirmojnë mungesën e interesimit nga prindërit, ata shohin probleme edhe tek vetë mësuesit, ndryshe nga vetë këta të fundit, që pothuajse të gjithë përgjegjësini e lenë tek prindërit. Në vazhdim, drejtuesit e shkollave, ndryshe nga mësuesit, pohojnë se këta të fundit nuk vlerësohen për punën me prindërit. Ndoshta bëhet fjale për dy aspekte të ndryshme të vlerësimit: atë zyrtar institucional dhe atë shoqëror, nga vetë prindërit dhe publiku.




Si pengesa për afrimin e prindërve ata shohin: problemet sociale, si emigracioni dhe varfëria, konceptin se edukimi i takon shkollës (që perputhen me ato të mësuesve) nivelin e ulët kulturor të prindërve, largësinë e shkollës. Kjo e fundit del në pah disa herë dhe për aspekte të ndryshme, por gjithnjë si një faktor negativ. Disa prej tyre përmendin *mungesën e besimit të prindërve se problemet që shtrojnë ata do të zgjidhen*. Ky shqetësim është përmendur edhe nga grupe të tjera si psh mësuesit dhe punonjësit socialë, por edhe vete prindërit. Klima në shkollë përmendet si një faktor tjetër me rëndësi që ndikon në ekzistencën ose mungesën e frymës së bashkëpunimit. Ka drejtues që shprehen se *mësuesit kanë frikë nga transparenca për cilësinë e punës dhe përgatitjes së tyre dhe prandaj kanë frikë ta përfshijnë prindin në shkollë*. Prandaj prindërit duhet të marrin pjesë në të gjitha analizat e punës së shkollës dhe të klasave. Ajo që vlen të veçohet nga përgjigjet e drejtuesve të shkollave është ***mungesa e traditës së një bashkëpunimi të mirëfilltë dhe mosnjohja e standardeve të pritshme të bashkëpunimit***.

Pikërisht për përhapjen e përvojës së suksesshme të këtij bashkëpunimi, e cila është baza për formimin e traditës, drejtuesit e shkollave këshillojnë:

- Aktivitete trajnuese dhe kualifikuese

- Përdorim të medias për sensibilizim
- Këmbim të përvojave me shkollat që kanë patur suksese në bashkëpunimin me prindërit
- Konferenca, ëorkshope, debate për problemet e bashkëpunimit dhe të edukimit
- Ndhimë dhe angazhim me i madh nga OJF
- Ndhimesë nga psikologët e shkollave



Këshillohen gjithashtu përgatitje *fletpalosjesh për të bërë të qartë detyrat dhe të drejtat e prindërve në shkollë dhe nevojën e përfshirjes së tyre në vendimmarrje, plane pune me projekte bashkëpunimi me prindërit, si dhe **caktimi i "ditës së prindit". Ky i fundit, mund të jetë një koncept mjaft interesant, nëqoftëse mbushet me një përmbajtje konkrete dhe tërheqese si për prindërit, ashtu edhe për mësuesit. Planifikimi i punës së shkollave me prindërit këshillohet të bëhet më i studjuar.***

Konkretisht, drejtuesit e shkollave rekomandojnë të bëhet punë e kualifikuar me prindërit për ndihmën që

mund t'u japin fëmijëve të tyre në drejtim të mësimi, si dhe mjedisit stimulues, që duhet ndërtuar në familje. Duhet *hapur dyert për nisma të përfshirjes së prindërve për menaxhimin e punës mësimore- edukative në shkollë.* Një drejtues shkolle rekomandon që prindërit mund të përfshihen në nivele të ndryshme në veprimtaritë që organizon shkolla, duke filluar që nga planifikimi e deri tek organizimi/ zbatimi, por qoftë edhe në ndjekjen e tyre si spektatorë.

Lidhur me trajnimet që rekomandohen prej tyre, përmenden: 1) rrugët, metodat dhe mjetet për nxitjen e prindërve për të bashkëpunuar me shkollën; 2) ndërgjegjësimi i mësuesve për detyrimet ndaj prindërve si ndaj klientëve të tyre dhe rolin që ka përmirësimi i punës me prindërit; 3) roli e përgjegjësitë e prindërve për edukimin e fëmijëve dhe rrugët më efektive për realizimin e kësaj përgjegjësie; 4) mënyrat e organizimit të prindërve. *Mendohet se ka mjaft përvoja të suksesshme brenda vendit, që mund të mblidhen dhe të përpunohen për të ndërtuar kurrikulat e këtyre trajnimeve.*



Drejtuesit e shkollave janë të ndërgjegjshëm për rëndësinë e rolit të tyre në dhënien e tonit marrdhënies dhe bashkëpunimit me prindërit si dhe në krijimin e imazhit të një shkolle që

drejtohet me përkushtim, ndershmeri dhe profesionalizem. Kjo mendojnë ata, është kyçi për të tërhequr prindërit në shkollë dhe për të bërë që ata të ndihmojnë dhe të marrin pjesë pa rezerva, madje edhe neqoftëse nuk ekziston ende një përvojë shumë e mirë e shkollës në këtë drejtim.


Drejtuesve të shkollave u është kërkuar mendimi edhe për atë se çfarë mund të bëhet për të ngritur në përgjithësi nivelin e përfshirjes së prindërve në çështjet arsimore të të gjitha niveleve, por përgjigjet kanë mbetur në nivel shkollë dhe nuk i japin përgjigje pyetjes së vërtetë. **Vizioni kufizohet kryesisht tek shkolla.** Ndër ato që ia vlen të përmenden janë:

Ka edhe drejtues që kanë një vizion pak më të qartë duke kërkuar që "MASH duhet ta bëjë problem të shoqërisë afrimin e prindërve në shkollë dhe detyrat që kanë ata për edukimin. Ajo duhet të shohë edhe çështjen e ngarkesës së mësuesve që ata të kenë më shumë ore për pune edukative dhe me prindërit".

trajnimi i drejtuesve për rolin e tyre në bashkëpunimin shkollë-familje dhe veçanërisht për punën me bordin e shkollës, organizim i aktiviteteve për nder të prindërve bashkëpunues nga organet arsimore në rreth, pushteti vendor e shkolla, krijimi e forcimi i shoqatave të prindërve.

Përsa i përket mbështetjes që u duhet drejtuesve të shkollave nga organet arsimore eprore, për të forcuar lidhjet me prindërit dhe komunitetin, ata shprehen për: shëmbuj konkretë dhe përhapje të përvojës pozitive si dhe seminare për këtë nga DAR, rregullime ligjore për përfshirjen e prindërve, motivim më i madh i mësuesve. Përmenden edhe stimujt ekonomikë dhe problemi i mbingarkesës.

Gjithashtu, drejtuesit e shkollave këshillojnë, që ashtu siç prindërit kërkojnë praninë e drejtuesve të shkollës në takimet me prindër, edhe drejtuesit e shkollave kanë nevojë për praninë e organeve arsimore eprore si DAR, bashkia apo komuna, për ta bërë bashkëpunimin me të vërtetë të frytshëm.



Në përgjithësi, vihet re se drejtuesit e shkollave janë pak a shumë të gatshëm për të marrë hapa të mëtejshme për të forcuar marrdhëniet me prindërit. Kjo gatishmëri është një parakusht për të nisur ndryshime masive në këtë drejtim. Ata janë të ndërgjegjshëm se kur bëhet fjalë për ndryshime të ndjeshme në legjislacion, në proces duhet të marrin pjesë të gjitha grupet e interesuara. Drejtuesit e shkollave përmendin veçanërisht rëndësinë e mësuesve neqoftëse bëhet fjalë që reformat të jenë të suksesshme.

Ata janë kategoria që duhet informuar, përgatitur dhe motivuar për të rritur bashkëpunimin me prindërit, por që mund të bëhen edhe vetë nxitësit e ndryshimeve që priten. Mund të thuhet se

Mbresëlënëse, përsa i përket mungesës së veprimtarive në rrethe është thënia e një drejtuesi shkollë: "Në opinionet e mësuesve tanë, kushdo që vjen nga Tirana, na duket se na sjell një privilegj, sikur edhe një seminar jashtë rrethit. Këtu jeta është e zymtë dhe shumë e varfër dhe niveli kulturor po vjen gjithnjë e në rënie." Kjo duhet të jetë një thirrje për organet arsimore qendrore për nevojat e gjallërimit të jetës profesionale të mësuesve dhe drejtuesve të shkollave në rrethe.

tek të dyja kategoritë mbizoteron më shumë optimizmi dhe besimi se sa indiferenca dhe cinizmi.

5. Organet drejtuese të arsimit

Drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat e arsimit në rrethe

Në pikëpamjen e DAR-eve përfshirja e prindërve është e lidhur drejtpërdrejtë me *autonominë shkollore*. Sa më shumë hapsira për vendimmarrje të ketë vetë shkolla, aq më e madhe do të jetë edhe mundësia e prindërve për t'u bërë pjesë e vendimeve si për lëndët, zgjedhjen e teksteve, po ashtu edhe për vlersimin dhe emërimin e mësuesve.

Pranohet se *më shumë duhet bërë për të trajnuar mësuesit se si të bashkëpunojnë me prindërit*, dhe këto tema duhet të futen në programet e trajnimeve që organizon DAR. Po kështu, dhënia e informacionit prindërve për sukseset dhe problemet e shkollës duhet të jetë më intensive. Ka DAR si psh ajo e Elbasanit, që ka futur *librezën e nxënësit* si një dokument komunikimi midis mësuesit dhe prindit. Madje ka ide që *DAR-et duhet t'u raportojnë në mënyrë të planifikuar prindërve dhe organeve përfaqësuese të tyre*. Atje ku ka përfaqësi me të zgjeruar prindërisht, psh nëpërmjet shoqatave, shihet edhe më e mundshme që DAR dhe shoqatat e prindërve të bashkëpunojnë në mënyrë të institucionalizuar, *nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të planeve të përbashkëta*. Ideja e një *bordi arsimit në nivel qarku*, me pjesëmarrje të përfaqësuesve të prindërve, është diçka e *pranueshme dhe e këshillueshme nga DAR-et*. DAR-et konfirmojnë edhe një herë se prindërit kanë rol të domosdoshëm në politikën e luftimit të braktisjes së shkollës si dhe realizimin e përqendrimit të shkollave kur ky është i nevojshëm.

Edhe sipas pikëpamjes së DAR-it, organet prindërore në shkolla, si *këshillat e prindërve dhe bordi, dominohen nga drejtuesit e shkollave dhe mësuesit*, pasi këta të fundit kanë në dorë vlersimin e nxënësve. Pohohet se *puna me prindërit, nuk përbën ende prioritet për shkollat* dhe se shumë drejtues kanë *interes të kenë borde inaktive për të vënë në jetë thjesht preferencat e tyre në drejtimin e shkollës*. Vetë prindërit duke kërkuar llogari mund të ndihmojnë shumë në procesin e transparencës. Po kështu, DAR-et nxjerrin në pah si pengesë për bashkëpunimin neglizhencën dhe indiferencën e të dy palëve: mësuesve dhe prindërve. Ato bëjnë thirrje që *organet drejtuese të arsimit, të të gjitha niveleve duhet të jenë me të përgatitura për të dëgjuar zerin e prindërve dhe për të përmbushur kërkesat e tyre*.

Ndërkohë, pohohet që monitorimi dhe vlersimi i punës së shkollave me prindërit nuk është i rregullt dhe sistematik.

MASH

Me MASH-in është bërë vetëm një intervistë me një përfaqësues të drejtorisë së kurrikulave, nga e cila rezulton se edhe DAR-et edhe shkollat nuk punojnë për përfshirjen e prindërve dhe këta të fundit nuk njohin mirë legjislacionin dhe të drejtat e detyrimet e tyre. Përgjegjësia për njohjen e kompetencave të prindërve u ngarkohet shoqatave të tyre. Ndërkohë, qendrimi ndaj pjesëmarrjes së prindërve në vendime për programet mësimore dhe tekste, është shumë pozitiv dhe i hapur. Po kështu, del e qartë lidhja dhe kushtëzimi i aktivitetit të bordit me ekzistencën e buxhetit të shkollës dhe autonominë e saj, dhe rëndësia e rregullimit institucional të marrdhënieve mes DAR e bordeve të shkollave.

6. Pushteti vendor: komuna dhe bashki

Niveli i ndërgjegjësimit dhe i ndjeshmerisë për problemet e arsimit në përgjithësi, tek pushteti vendor është me i ulët, krahasuar me DAR-et, gjë që është deri diku e pritshme po të kihet parasysh numri i madh çështjeve me të cilat duhet të merren organet e pushtetit vendor, si edhe faktin që deri tani, përgjegjësia e tyre për shkollat është kufizuar kryesisht në aspektet e infrastrukturës fizike. Megjithatë, niveli i interesimit varion në vartësi të përvojës dhe të shkuarës profesionale të punonjësve që mbulojnë arsimin. Në rastet kur ata vetë vijnë nga arsimit, si ish-mësues apo drejtues shkollash, edhe idetë e tyre janë më të pasura e konkrete.

Lidhur me përfshirjen e prindërve, nuk mund të thuhet se këto struktura mund të jenë në një të ardhme të afërme aktori kryesor për ndryshimet që kërkohen. Ka raste kur pranohet se nevojat a arsimit dhe problemet që duhet të përballojnë shkollat nuk mund të zgjidhen vetëm nga ato dhe DAR-et, por kërkojnë pjesëmarrjen e të gjithë aktorëve të interesuar si dhe mendimin e tyre. Propozohet *ngritja e grupeve të përbashkëta prindër-drejtori shkolle-pushtet vendor, për të vlerësuar problemet dhe për të ndërmarrë zgjidhjet e duhura.* Pohohet se këshillat e prindërve të shkollave janë ftuar në mbledhjet e këshillit bashkiak, ku është diskutuar për buxhetin e shkollave dhe detajimin e tij, dhe se shihet e mundur që t'u akordohen fonde nga pushteti vendor shoqatës së prindërve, për veprimtari të përbashkëta për mirëmbajtjen e shkollave dhe përmirësimin e kushteve të edukimit.

Vihet re se këtu mund të ketë vend për më shumë përpunim dhe plotësim të aspekteve ligjore, për të unifikuar dhe përcaktuar më mirë metodat dhe organizmat e bashkëpunimit, pasi në disa pushtete vendore, bashkëpunohet me këshillat e prindërve, në disa të tjera me bordet e shkollave dhe në disa të tjera, me shoqaten e prindërve. Ka edhe mjaft raste ku bashkëpunimi i institucionalizuar mungon fare dhe pushteti vendor e ndjen veten përgjegjës vetëm për anën fizike të institucioneve arsimore, kurse "te tjerat, i di DAR".

7. Shoqëria civile dhe organizatat ndërkombëtare

Përfaqësuesit e tyre ngrenë të njëjtat probleme siç janë përmendur deri tani. Një përvojë interesante është ajo e Plan Albania, e përdorur në Librazhd, për të lidhur prindërit me shkollën nëpërmjet “grupeve të komunikimit”. Këto grupe përbëhen nga nxënës, të cilët vizitojnë familjet e shokëve të tyre dhe informojnë prindërit për problemet e shkollës, dhe i ftojnë që të jenë të pranishëm në të dhe të ndihmojnë në zgjidhjen e tyre.

G. Përfundime

Studimi tregon se ka mjaft variacione në përfshirjen e prindërve në edukim në shkallë vendi por gjithsesi, mund të përcaktohen disa rezultate të përgjithshme. Nga analiza përmbledhëse e rezultateve dalin në pah aspekte si pozitive po ashtu edhe negative, lidhur me nivelin e përfshirjes së prindërve në shkollë dhe në vendimmarrje në fushën e edukimit. Për lehtësi paraqitjeje, analiza në vijim do të bëhet duke i grupuar në arritje dhe *mangësi*.

Arritje:

- Një nivel përgjithësisht i kënaqshëm i vlersimit të rolit dhe punës së shkollave dhe mësuesve nga ana e prindërve. Kjo është shprehur në mënyra të ndryshme por përgjithësisht vihet re qartë që prindërit e respektojnë shkollën dhe mësuesit si një institucion i specializuar që punon për edukimin e fëmijëve të tyre. Ekziston ndërgjegjësim nga ana e prindërve për vështirësitë e punës së mësuesve, dhe njëkohësisht vlersohet përgatitja e mësuesve në takimet me prindër që organizon shkolla dhe shpeshësia e tyre. Pra, tek prindërit, pavarësisht nga kritikata, ekziston bindja se shkolla është një institucion i respektuar, që u shërben atyre dhe me të cilin ata duan të bashkëpunojnë. Kjo është një bazë e mirë psikologjike për të punuar më tej në drejtim të forcimit të bashkëpunimit prindër-shkollë.
- Si nga ana e prindërve, po ashtu edhe nga ajo e mësuesve janë të qarta përfitimet që do të kishin fëmijët, shkollat dhe familja nga një bashkëpunim dhe përfshirje më e madhe e prindërve në jetën e shkollës. Pyetjet mbi dobinë e bashkëpunimit kanë marrë përgjigje mjaft konkrete dhe të detajuara, që sërisht tregon se në thelb, qendrimet ndaj bashkëpunimit janë pozitive. Veçanërisht, tek mësuesit nuk shfaqet prirja e nënvleftësimit të prindërve dhe aftësive të tyre si edukatorë, që është përgjithësisht pikënisja e qendrimeve neglizhente dhe e një fryme jo të mirë komunikimi mes tyre dhe prindërve. Perceptimi i një “supremacie kulturore” të mësuesve përkundërt prindërve përbën kudo një nga barrierat më të vështira për t’u mposhtur, dhe pengesën më të madhe për pjesëmarrjen e prindërve. Në praktikë ajo shfaqet me mungesën

e respektit ndaj prindit, mosmarrjen parasysh të vërejtjeve dhe kërkesave të tyre, ftohtësinë në komunikim dhe madje shmangien e tij, etj. Qendrimet e tilla, nuk është se mungojnë tek mësuesit, por shkalla e tyre nuk duket problematike.

- Mësuesit dhe veçanërisht drejtuesit e shkollave dhe të DAR-eve, janë mjaft pozitivë ndaj përvojës së një bashkëpunimi më intensiv me prindërit, nëpërmjet bordeve dhe këshillave të tyre. Në shkollat ku bordi vepron, përvojat janë përgjithësisht të mira dhe tregojnë se është plotësisht e mundur që prindër të përgatitur dhe të interesuar, të marrin pjesë aktive në çështje të drejtimit të shkollës, përfshirë edhe buxhetin. Meqenëse, drejtuesit e shkollave kanë marrë disa kompetenca financiare njëkohësisht dhe paralel me bordin, bashkëpunimi ka qenë më i lehtë për t'u ndërtuar sesa nëqoftëse drejtuesit do vinin nga një përvojë e gjatë e manaxhimit të fondeve nga vetë ata. Drejtuesit e shkollave dhe të DAR-eve janë gjithashtu shumë të hapur për të bërë prindërit pjesë të vendimeve për emërimin dhe shkarkimin e personelit mësues. Ndonëse kjo mbetet një çështje shumë delikate dhe madje deri diku edhe e politizuar, të paktën në opinionet e njerëzve, organet arsimore në përgjithësi shprehën pozitivë ndaj një vendimmarrjeje të përbashkët me prindërit. Shpjegimet mund të jenë të ndryshme, që nga pakënaqësia nga defektet e deritanishme në sistemin e emërimit, vlersimit dhe shkarkimit të mësuesve dhe drejtuesve të shkollave, e deri tek nevoja për të sjellë vendimet më afër shkollës, dhe respektimi i opinionëve dhe kërkesave të prindërve si klientët e shkollave. Edhe pse kjo mundet mos jetë detyrimisht rruga që duhet ndjekur, të paktën tani për tani, një klimë e tillë mirëbesimi dhe vlersimi të rolit të prindërve është një arritje shumë pozitive dhe që mund të përdoret në drejtime të tjera të forcimit të pjesëmarrjes së prindërve. E rëndësishme është që bordet dhe këshillat e prindërve konsiderohen si organizma të rëndësishme për drejtimin e shkollave dhe përfshirjen e prindërve.
- Gatishmëria e prindërve dhe e mësuesve për të rritur nivelin e njohurive dhe shprehive të tyre si edukues, dhe për të bashkëpunuar me prindërit, është në një nivel mjaft të kënaqshëm. Duket se ka ndërgjegjësim për rolin dhe vlerën e trajnimeve, si nga mësuesit po ashtu edhe prindërit, dhe interes për të marrë pjesë në to. Kjo përbën një kusht të domosdoshëm për suksesin e programeve të trajnimit, sidomos atyre të nivelit kombëtar dhe që përfshijnë një masë të madhe mësuesish.

Mangësi:

- Niveli i ulët i ndërgjegjësimit të prindërve për rolin dhe detyrimet e tyre si edukatorë, dhe prirja për të deleguar përgjegjësinë kryesore tek shkollat dhe mësuesit. Ky është një fakt i konstatuar gjërësisht dhe i pranuar edhe nga vetë prindërit. Një nga treguesit e ndërgjegjësimit të pakët është edhe pjesëmarrja e ulët në takimet me prindër që organizon shkolla, e cila nuk shkon as

50%, ndërkohë që një shifër e kënaqshme, edhe e krahasuar me përvojat ndërkombëtare, do të ishte rreth 80%. Në vijim, cilësia e pjesëmarrjes është e dobët, e shprehur me një qëndrim më tepër pasiv dhe pritës të prindërve se sa aktiv dhe sugjerues ndaj mësuesve dhe shkollës. Në tërësi, një gjendje e tillë mund të rrjedhë nga një kombinim faktorësh si: niveli përgjithësisht i ulët arsimor i prindërve, rëndësia e pakët që ata i kushtojnë arsimit si një mjet për të siguruar një të ardhme më të mirë për fëmijët e tyre, vështirësitë në përballimin e jetës së përditshme dhe sigurimin e të ardhurave për familjen, që detyrimisht e zhvendos arsimin si prioritet kryesor për ta, etj.

- *Dobësi në përgatitjen e mësuesve dhe drejtuesve të shkollave për të komunikuar dhe bashkëpunuar me prindërit.* Mungojnë njohuri të specializuara për punën me prindërit si gjatë formimit fillestar, po ashtu edhe gjatë atij në punë. Pak është bërë për të përgatitur programe trajnimi për mësuesit dhe prindërit dhe mungon edhe një trupë apo grup trajnuesish të specializuar për të realizuar programe të tilla. Shumica e të nxëniet në këtë drejtim zhvillohet nëpërmjet këmbimit të përvojave mes vetë mësuesve dhe ndihmës praktike që marrin nga eprorët e tyre (drejtuesit e shkollave).
- *Dobësi të theksuara në aftësitë për vetëorganizim dhe përfaqësim të prindërve, në të gjitha nivelet.* Kjo shfaqet me anë të mbizotërimit të rolit të mësuesve në këshillat e prindërve dhe të atij të drejtuesve të shkollave në funksionimin e bordeve të shkollave (tek këta të fundit madje edhe për të vendosur për krijimin e tyre) si dhe me mënyrën e zgjedhjes, që kryesisht ka protagonist kryesor mësuesin kujdetar dhe drejtuesin e shkollës. Nëqoftëse kjo situatë vazhdon, bordet nuk do të mund të kryejnë si duhet rolin e tyre si përfaqësues të masës së prindërve dhe komunitetit, në aspekte të rëndësishme që përmenden shpesh si: çështje të personelit, vlersimit të punës së shkollës, manaxhimit të fondeve, etj. Kjo, gjithashtu rrezikon të kthejë këshillat e prindërve (atje ku ato funksionojnë) në instrumenta që përçojnë vetëm nga shkolla tek prindërit, dhe jo anasjelltas, dhe nuk do të krijojë asnjë nxitje për të rritur nivelin e demokracisë dhe pjesëmarrjes në to. Për bordet e shkollave del si problem i mprehtë pavarësia e tyre nga drejtori i shkollës dhe transparenca në veprimtarinë e ndërmarra dhe vendimet e miratuara. Kjo përbën një domosdoshmëri, nëqoftëse bordeve dhe këshillave do t'u duhet të marrin një rol më të rëndësishëm në vendimmarrje. Gjithashtu përbërja e tyre paraqet shqetësim, për shkak të prirjes për të tërhequr kryesisht prindër biznesmenë, duke patur ndihmat financiare për shkollën si qëllim kryesor të pasjes së bordit.
- *Mungesë strukturash përfaqësuese për përfshirjen e prindërve përtej nivelit të shkollës (DAR, pushtet vendor, MASH).* Dobësi të theksuara në shtrirjen dhe funksionimin e shoqatave të prindërve sidomos në nivel kombëtar dhe për pasojë edhe mungesën e një bashkëpunimi të institucionalizuar në nivel kombëtar mes MASH dhe një përfaqësie demokratike të prindërve. Shoqatat ekzistuese janë kryesisht me karakter të theksuar lokal dhe të varuara nga donatorët e ndryshëm, të paktën në aspektin financiar. Nuk mund të thuhet se në Shqipëri ekziston një lëvizje e mirëfilltë prindërore, që do

të mund të ushtronte trysni tek vendimarrësit për çështje të rëndësishme të arsimit. Kjo gjendje mund të jetë pasojë e mungesës së bashkëpunimit dhe përfaqësimit të prindërve në nivel shkolle dhe është pikërisht në këtë nivel që duhet të fillojë të ndryshojë dhe të përmirësohet.

H. Çfarë sugjeron përvoja ndërkombëtare

Niveli i pjesëmarrjes së prindërve në jetën e shkollës dhe në vendimarrjen arsimore të niveleve të ndryshme paraqet variacione nga një vend në tjetrin. Ai është rezultante e disa faktorëve të njëkohshëm si: rëndësia që i jepet arsimit për përcaktimin e të ardhmes të fëmijës dhe statusit të tij ekonomik e shoqëror në një shoqëri të caktuar, niveli i formimit arsimor dhe kulturor të vetë prindërve që përcakton shkallën e përgatitjes së tyre për të komunikuar me shkollën dhe mësuesit si dhe pritshmëritë e tyre, mënyra se si janë formuar dhe trajnuar mësuesit përsa i takon bashkëpunimit me prindërit dhe respektimin e tyre si bashkëedukues të fëmijës dhe si klientë të shkollës, niveli i pjesëmarrjes në përgjithësi në jetën politike e sociale që përbën një pasqyrim të nivelit të përgjithshëm të demokratizimit të shoqërisë, ndikimi i traditës, etj.

Për të bërë të mundur zbatimin e atyre aspekteve të përvojës ndërkombëtare që janë të mundshme për Shqipërinë, krahasimi është bërë me dy vende antare të reja të Bashkimit Europian, përkatësisht Sllovenia dhe Rumania. Ngjashmëria në disa aspekte të të kaluarës së vonë, por edhe në standardet që duhen arritur me pranimin në Bashkimin Europian, e bën referencën ndaj sistemeve të tyre arsimore praktikisht më të vlefshme se sa krahasimi me modele të tjera më të përparuara, por më pak të zbatueshme tek ne.

Përvoja rumune dëshmon për një rifillim të ri të përfshirjes së prindërve në edukim, që përqendrohet në aftësimin masiv dhe të organizuar të prindërve për rolin e tyre si prindër dhe edukues. Kjo është realizuar nëpërmjet programeve kombëtare, të drejtuara nga Ministria e Arsimit. Programi zbatohet nëpërmjet shoqatave të prindërve, të cilat bashkërendojnë temat e trajnimit për këtë qëllim. Një përpjekje e tillë shihet si një fillim i përshtatshëm për të hedhur bazat e ndërgjegjësimit të prindërve për rolin dhe rëndësinë e tyre si edukatorë të fëmijëve, gjë që përbën edhe bazën parimore dhe psikologjike për përfshirjen e tyre në shkollë dhe në të gjitha nivelet e tjera të vendimmarrjes arsimore.

Ndërkohë, janë bërë mjaft investime për krijimin e një lëvizjeje prindërore në rang kombëtar, duke filluar me krijimin e shoqatave të prindërve fillimisht mbi bazë shkolle dhe pastaj antarësimin e tyre në një strukturë kombëtare, mbi baze interesash e përfitimesh praktike nga antarësia në këtë strukturë. Ndonëse ende mungon një lëvizje e mirëfilltë dhe aktive në rang kombëtar, duket se ajo çka është arritur dhe ajo që po bëhet deri tani, është pikërisht në drejtimin e duhur.

Rumania, ka ruajtur dhe madje po forcon një sistem kombëtar të centralizuar për emërimin dhe vlersimin e mësuesve dhe drejtuesve të shkollave, gjë që ka anën pozitive të vendosjes dhe zbatimit të standardeve të njëjta kombëtare dhe sigurimit të mundësisë për lëvizshmëri profesionale të mësuesve dhe drejtuesve të shkollave në të gjithë vendin. Bordet dhe këshillat e prindërve nuk janë të përfshirë në këtë drejtim. Ata, vërtet japin mendime dhe vlersime për mësuesit, por nuk kanë ndonjë vendimmarrje në emërimet. Një zgjidhje e tillë duket vendim i përshatshëm në kushtet kur demokracia lokale nuk është ende e zhvilluar si duhet, dhe mund të degjenerojë në mbizotërim të interesave të ngushta lokaliste dhe gjykimeve të cekta dhe të kufizuara ndaj mësuesve dhe drejtuesve të shkollave.

Drejtimi ku bordi i shkollës ka marrë shumë përparësi në vendimmarrje është ai i caktimit të lëndëve me zgjedhje që ofron shkolla, si edhe përzgjedhja e aktiviteteve jashtëkurrikulare. Po kështu, organizmat prindërore po marrin më shumë vendime përsa u takon financave dhe aspekteve administrative të shkollave.

Përsa i përket ndjekjes së takimeve me prindër, vihet re një ndryshim i ndjeshëm me Shqipërinë, ku pjesëmarrja është nën 50%. Në Rumani, kjo pjesëmarrje shkon tek 80% dhe është e tillë për shumicën e vendeve të zhvilluara.

Në përgjithësi, sipas gjyqimit të mësuesve dhe specialistëve të fushës së arsimit, përfshirja prindërore në çështjet e edukimit ndeshet me problemet tipike të njëfarë pamundësie dhe paaftësie të prindërve për të qenë aktivë sa duhet, dhe dobësive të organizimit të efektshëm në nivel kombëtar. Megjithë përparimet konkrete në drejtim të krijimit të shoqatës kombëtare të prindërve, nuk është arritur ende që prindërit të kenë një përfaqësi efektive të tyre në diskutimet dhe negociatat me Ministrinë e Arsimit. Në Slloveni përfshirja e prindërve është në nivele të kënaqshme dhe dhjetëvjeçarin e fundit janë bërë përparime të ndjeshme. Legjislacioni është përpunuar dhe pasuruar përsa i përket përfshirjes prindërore në aspektet e edukimit të fëmijëve dhe të bashkëpunimit real në çështjet e edukimit. Kështu p.sh., legjislacioni parasheh si detyrim të përbashkët midis shkollës dhe prindit moshën e pranimit në shkollë, të drejtën e prindërve për të sjellë fëmijën në shkollë, mungesat dhe detyrat e prindit për kapërcimin e prapambetjes në mësimet për shkak të tyre, komunikimin e rezultateve të nxënësit dhe të drejtën e prindit për t'i kundërshtuar ato, pjesëmarrjen në komisionet dhe bordet vendimmarrëse shkollore, komunikimin në rast sëmundjeje apo lëvizjeje etj. Një përparim i detyrimeve të prindit ndaj fëmijëve i paraparë në legjislacion është edhe ai i arsimit të fëmijës në shtëpi, ku prindi merr të gjithë përgjegjësinë për të por edhe ka të drejtën e bashkëpunimit me shkollën, për ekspertizë, vlerësim etj. Pjesëmarrja e prindërve në veprimtaritë shkollore dhe në mbledhjet e rregullta është shumë e lartë, pranë 90%.

K. Këshilla për vendimmarrësit

Kryerja e këtij studimi ka synuar daljen me *sugjerime konkrete për vendimmarrësit e arsimit*, lidhur me ato që mund të bëhen për të përfshirë me shumë prindërit në jetën e shkollës dhe në politikat arsimore të të gjitha niveleve. Ndonëse në raportin e studimit janë pasqyruar të gjitha sugjerimet nga grupet përkatëse (prindër, mësues, drejtues shkollash, psikologë, pushteti vendor, etj), sugjerimet e mëposhtme nuk janë një pasqyrim apo përmbledhje mekanike e tyre, por rezultat i një analize përzgjedhëse që merr parasysh çfarë është e mundshme në kushtet aktuale, dhe një rrjedhe logjike në hapat që duhen hedhur. Gjithashtu, janë marrë parasysh edhe rreziqet e mundshme për zbatimin e disa rekomandimeve të bëra nga të intervistuarit. Këshillat janë paraqitur në formë pak a shumë të përmbledhur, pasi pritet që përfundimet e studimit të përdoren për të përpunuar nga Grupi i Punës, propozime me të plota dhe të detajuara për t'u përfshirë në Planin e Veprimit të MASH.

- a) Bazuar në rekomandimet e dhëna nga grupet e ndryshme, del se një nga hapat parësore që duhet hedhur për të përmirësuar dhe intensifikuar pjesëmarrjen e prindërve në çështjet e arsimit, **është ngritja e nivelit të ndërgjegjësimit të tyre për vlerën e arsimit të fëmijëve të tyre, si dhe përparësitë dhe përfitimet nga prania e prindërve në shkollë, dhe përfshirja në zgjidhjen e problemeve të arsimit në përgjithësi**. Kjo do të ishte një përgjigje efektive ndaj indiferencës dhe pasivitetit të masës së prindërve. Sigurisht që prania e prindërve në shkollë dhe bashkëpunimi me mësuesit nuk mund të forcohen neqoftëse prindërit nuk janë ende sa duhet të ndërgjegjshëm për rolin që luan një arsimim cilësor për të ardhmen ekonomike e sociale të fëmijëve të tyre. Pra, ajo që sugjerohet është një *fushatë efektive ndërgjegjësimi për vlerat dhe dobritë praktike të marrjes së një arsimit sa më cilësor dhe ndryshimet që mund të sjellë kjo në jetën e fëmijëve, sidomos atyre të familjeve me të ardhura të pakta*. Konkretisht, këshillohet të ndërmerret një *fushatë ndërgjegjësimi për prindërit për nevojën për arsimim, si dhe rolin, të drejtat dhe detyrimet e tyre në procesin e edukimit të fëmijëve të tyre në shtëpi dhe në shkollë*. Fushata duhet të jetë në nivel kombëtar dhe një ndërmarrje afatgjatë me përfshirje të radiove dhe televizioneve kombëtare dhe lokale, gazetave dhe revistave të fushës së arsimit, si edhe të një programi kombëtar të trajnimit për mësuesit dhe prindërit. Ajo duhet të përshtatet me nivelin kulturor të masës së prindërve dhe t'u përgjigjet nevojave të tyre për komunikim, duke përdorur mënyra sa më krijuese dhe larg shabloneve dhe klisheve të konsumuara. *Fushata duhet të programohet afatgjatë, pasi synon ndryshime në mendësi, që nuk janë të lehta për t'u arritur dhe duhet të sigurojë me anë të vazhdimësisë së saj një nivel kritik vëmendjeje dhe interesimi nga prindërit. Përmbajtja dhe mënyrat e zhvillimit të saj, mund të testohen fillimisht në disa rrethe, por gjithnjë me qëllimin final, atë të një fushate kombëtare*. Kjo është e domosdoshme sidomos për të zhvilluar sensin e solidaritetit dhe organizimit mes prindërve kur është fjala për pjesëmarrje në vendime të rëndësishme të arsimit, të cilat nuk mund të realizohen në kuadrin e një shkolle apo vetëm të një rrethi. *Fushata duhet të*

programohet nga një grup mikst prej specialistësh të arsimit dhe atyre të mediave për të siguruar një përmbajtje optimale dhe kanale të realizimit sa më efektive. Ajo duhet të miratohet paraprakisht nga MASH, e cila duhet të jetë një aktore aktive edhe në realizimin e saj.

- b) ***Ngritja e kapaciteteve të mësuesve, drejtuesve të shkollave dhe prindërve për rritjen e bashkëpunimit në nivel shkolle.*** Kjo synon në rradhë të parë prindërit që janë antarë të këshillave të klasave dhe shkollës si dhe të bordit, por edhe prindër të tjerë, në masën që është e mundur dhe e përballueshme. Qëllimi është *rritja e efikasitetit të funksionimit të organeve prindërore mbi bazë shkolle*, si hapi i parë për të rritur aftësitë konkrete të prindërve për të ushtruar avokaci në interes të fëmijëve të tyre. Kjo aftësi e ushtruar fillimisht në shkollë, shihet si hapi i parë për të rritur përfshirjen e tyre për çështje arsimore më të larta dhe me aktorë të tjerë si DAR, MASH apo pushteti vendor. Kjo do të mund të realizohet nëpërmjet dy aktiviteteve kryesore të ndërlidhura mes tyre: *hartimi i kurrikulave të trajnimit për mësuesit dhe për prindërit, për rolet, detyrat e tyre si dhe metodat e bashkëpunimit*, duke u bazuar gjerësisht në legjislativën në fuqi, por duke mos u kufizuar vetëm në të; *përgatitja e një grupi trajnerësh të specializuar për bashkëpunimin shkollë-prindër*, të përzgjedhur në tregun e trajnuesve të fushës së arsimit nëpërmjet konkurrencës profesionale. Ky grup mund të marrë përsipër realizimin e trajnimeve të tilla në shkollë sipas një programi të miratuar dhe të mbështetur nga MASH. *Programi i trajnimit do të jetë një ndërmarrje afatgjatë disavjeçare*, e cila synon të plotësojë boshllëkun në përgatitjen e mësuesve, por edhe mungesën e njohurive dhe shprehive të prindërve. Programi mund të përfshijë incentiva për mësuesit pjesëmarrës duke u dhënë psh, pikë shtesë në kualifikimet e tyre ose në vlersimin e punës.
- c) Për t'i dhënë rëndësinë e duhur bashkëpunimit shkollë-prindër duhet që ky të mos i lihet spontanitetit dhe vetëm dëshirave të mira të disa mësuesve dhe drejtuesve shkollash, por duhet të *kthehet në pjesë integrale të punës së shkollave dhe personelit mësuesor*. Pra, bashkëpunimi me prindërit, duhet të kërkohet, monitorohet dhe vlerësohet nga DAR-i dhe MASH-i për shkollat dhe mësuesit. Që kjo të bëhet e mundur, duhet të *hartohen kriteret dhe standardet e kërkesave dhe vlersimit të unifikuar dhe të miratuara nga MASH*, për të gjithë vendin. ***Përcaktimi i normave dhe standardeve të vlersimit të mësuesve dhe shkollave*** duhet të përfshijë një sërë aspektesh si psh. *shpeshësia dhe cilësinë e takimeve me prindër*. Këto duhet t'u bëhen të qarta mësuesve dhe drejtuesve të shkollave dhe duhet të formojnë një sistem kaskade të monitorimit dhe vlersimit. Kjo do të thotë që *mësuesit duhet të vlersohen nga drejtuesi i shkollës dhe vetëshkolla dhe drejtuesi i saj nga DAR, mbi cilësinë e marrdhënieve me prindërit dhe nivelin e përfshirjes së tyre në jetën e shkollës*. Përcaktimi i tyre duhet të jete objekt i një pune të përbashkët të mësuesve, drejtuesve të shkollave, prindërve dhe specialistëve të arsimit për të dalë me një produkt që i përgjigjet gjendjes dhe mundësive aktuale të shkollave dhe që mund të rishikohet për t'u përmirësuar në të ardhmen. Aspekte të tilla si psh *pjesëmarrja e prindërve në borde pranë DAR-eve apo bashkive e komunave*, apo prania e

përfaqësuesve të DAR, e pushtetit vendor në takime me prindër, mund të shqyrtohen dhe të vendosen si mundësi gjatë diskutimeve dhe punës për *hartimin e standardeve dhe kriterëve të mësipërme*. Gjatë intervistave dhe pyetësorëve të studimit kanë dalë propozime të tilla, por grupi i studimit mendon se ka nevojë për më shumë analiza dhe diskutime për mundësite konkrete për ta realizuar këtë në shkolla. Gjithashtu, edhe ideja e pasjes së një mjedisi të posaçëm për prindërit në shkollë, duhet të jetë pjesë e ketyre diskutimeve, pasi me grupin e punës, diskutimi tregoi se kushtet e shkollave dhe infrastruktura e tyre janë të ndyshme. *Organizimi i ditës së prindit* në çdo shkollë mund të jetë pjesë e po këtij diskutimi, ose ajo mund të përfshihet si pjesë e fushatës së ndërgjegjësimit për prindërit. Ideja është që nëqoftëse *dita e prindit* duhet të fitojë qytetarinë saj në shkollat tona, ajo duhet të miratohet si pjesë e programit të detyrueshëm të veprimtarive të tyre me prindërit. Përmbajtja e saj dhe aktivitetet që mund të kryhen në këtë kuader në secilën shkollë, krahas udhëzimeve dhe rekomandimeve nga MASH apo DAR, mund t'u lihet në dorë edhe krijimtarisë së mësuesve dhe drejtuesve të shkollave si dhe këshillave të prindërve. Në vijim, po në këtë kuader, këshillohet që të shqyrtohet në përgjithësi ideja e *rregullimeve ligjore për përfshirjen e prindërve në vendimet e DAR-eve dhe pushtetit vendor*. Kjo sigurisht, mund të kërkojë nisma që dalin jashtë kuadrit të MASH, dhe për pasojë, mund të jetë më e vështirë për t'u realizuar, por gjithsesi, ia vlen që të jetë temë e një diskutimi dhe debati me të zgjeruar.

- d) Për të nxitur dhe fuqizuar bashkëpunimin shkolle-familje, këshillohet të ***shfrytëzohen aftësitë sado modeste të psikologëve dhe punonjësve socialë të shkollave***, si *burime njërëzore shtesë* në dispozicion të këtyre të fundit. Meqenëse, prania dhe puna e këtij kontigjenti është një përvojë e re dhe ende e pavlerësuar si duhet, këshillohet që të *ndërmerret një studim për të parë aftësitë konkrete dhe kufizimet e kësaj kategorie punonjësish*, si dhe, ku dhe si mund të jenë me të dobishëm për komunikimin mes prindërve dhe mësuesve e drejtuesve të shkollave, si dhe për trajnime për mësuesit dhe prindërit në nivel shkolle.
- e) Një nga aspektet që është rekomanduar nga disa drejtues shkollash, por që nuk është përfshirë në këshillat e studimit, është *marrja përsipër e emërimeve të mësuesve dhe drejtuesve të shkollave nga bordi i shkollës*. Ndonëse duket sikur ka një popullaritet të idesë mes mësuesve, drejtuesve si dhe disa mes vetë prindërve, ndjehet e nevojshme të thuhet se *kjo mund të jetë ende e parakohshme*, për vetë faktin e pershkruar në paragrafët përkatës, se bordet si edhe vetë këshillat e prindërve nuk gëzojnë atë nivel demokratizimi në zgjedhjet dhe përfaqësimin që është parakusht për detyra dhe funksione të tilla të rëndësishme dhe delikate. Neqoftëse dhënia e funksioneve të tilla bordit mendohet se mund të zgjidhë disa nga problemet ekzistuese si politizimin dhe mungesën e kriterëve të qarta profesionale në përzgjedhjen dhe emërimin e personelit arsimor, ne terheqim vëmendjen, se *edhe kalimi i papjekur dhe i papërgatitur i kompetencave të till tek bordi, mund të jetë po aq, në mos edhe më problematik*, sidomos në mungesë të një sistemi të mirëfilltë dhe efikas llogaridhënieje

të bordit ndaj masës së prindërve. Ajo që këshillohet tani për tani është **ndryshime dhe plotësime ligjore për saktësimin e rolit të bordit** për bashkëmanaxhimin (sëbashku me drejtuesin e shkollës) e fondeve të shkollës, mënyrat rigorozisht demokratike të zgjedhjes në to dhe në këshillat e prindërve dhe shoqatat. Vetëm pasi të jetë arritur një pavarësi e bordeve nga drejtuesit e shkollave dhe ajo e këshillave nga mësuesit kujdestar si dhe drejtuesit e shkollave, si dhe llogaridhënia, mund të hidhen hapa konkrete në fuqizimin e tyre me përgjegjësi e kompetenca të reja.

Puna e njëkohshme në drejtimet e mësipërme, do të duhet të bëhet nëpërmjet një programi të miratuar dhe udhëhequr nga MASH. Shumë aspekte, kanë nevojë për studime dhe thellim apo analiza të mëtejshme para se të vendosen dhe të bëhen pjesë e praktikave të detyrueshme të punës së shkollave.

SHTOJCË

Pasqyrë të dhënash të përmbledhura nga pyetsorët dhe intervistat

Takimet me prindër

- Shumica e prindërve përgjigjen se kanë shkuar 3 herë në takim me prindër gjatë vitit shkollor.
- Ka shumë pak prindër që nuk kanë shkuar asnjë herë të takimet me prindër
- Vendi ku bëhen takimet me prindër është në shumicën e rasteve klasa dhe ajo konsiderohet një mjedis i kënaqshëm.
- Në takimet me prindër diskutohet më shumë për notat, sjelljen, tekstet, kushtet fizike të shkollës, problemet e mjeteve mësimore.
- Mësuesit janë të gatshëm për takime të veçanta individuale, por rrallë kërkojnë të tilla.

Organizmat prindërore

- Bordet ekzistojnë dhe janë aktive në shumicën e shkollave, por ndërkohë që përgjegjësitë e tyre njihen relativisht mirë, vendimet që marrin njihen pak nga masa tjetër e prindërve.
- Ka mjaft vartësi të bordeve nga drejtuesit e shkollave dhe prindërit biznesmenë.
- Prindërit kërkojnë që bordi të transmetojë shqetësimet dhe propozimet për zgjidhje në organet arsimore më të larta.
- Drejtuesit e shkollave kërkojnë më shumë të drejta dhe rol për bordin në manaxhimin e fondeve të shkollave.
- Këshillat e prindërve konsiderohen të zgjedhura nga vetë prindërit nga shumica e tyre, por kërkohet më shumë llogaridhënie nga prindërit që marrin pjesë në to.
- Sugjerohet që ato të marrin më shumë rol përsipër dhe të kenë një mjedis të tyrin në shkollë për t'u mbledhur dhe për të ruajtur dokumentacionin e tyre.
- Vetëm 7,6% e prindërve pohojnë se bëjnë pjesë në një shoqatë prindërishe
- Shoqatat ekzistuese janë në zonat ku kanë punuar donatorët dhe të varura financiarisht prej tyre.
- Mungon shoqata kombëtare e prindërve me shtrirje në të gjithë vendin dhe me struktura përfaqësimi.

Vlerësimi për mësuesit

- Nga ana e prindërve është dashamirës dhe respektues.
- Prindërit kërkojnë motivim të mësuesve me paga më dinjitoze.
- Ka kritika përsa i përket mungesës së ngrohtësisë nga ana e mësuesve, mitmarrjes, mësimdhënies pa cilësi, trysnisë për kurse private, mungesës së transparencës për fondet e mbledhura nga prindërit, etj.

- Kërkohen bërja e anketimeve nga shkolla dhe mësuesit për të tërhequr mendimet e prindërve, vendosja e një kutie postare brenda shkollës ku prindërit të lenë me shkrim mendimet dhe sugjerimet e tyre.
- Kërkohet prania e DAR, pushtetit vendor në takimet semestrale me prindërit dhe/ose përfaqësia e prindërve dhe bordeve pranë tyre.
- Prindërit mirëpresin trajnime dhe marrje njohurish nga mësuesit.
- Roli i psikologëve dhe punonjësve socialë të shkollave është pak i njohur dhe i pak i shfrytëzuar për sa i takon ndërtimit të marrdhënieve prindër-mësues.
- Prindërit ndjehen shpesh inferiorë ndaj mësuesve dhe interesohen pak për çështje të shkollës ose arsimit që nuk kanë të bëjnë drejtpërdrejt me fëmijën e tyre.
- Rezultatet e ulta në shkollë të fëmijës, krijojnë akoma më shumë barriera psikologjike për prindin për të komunikuar me mësuesit.

Pikëpamjet e mësuesve

- Mësuesit kërkojnë nga prindërit kryesisht të kontrollojnë nëse fëmijët nxënë në shtëpi, të dhëna mbi personalitetin e tyre, ndihmë për detyrat e shtëpisë, njohuritë e specializuara të prindërve në fusha të ndryshme me interes për shkollën.
- Shumica dërrmuese nuk kanë marrë trajnime për punën me prindërit, por pohojnë se ndihmohen nga kolegët dhe vlersohen nga eprorët për këtë.
- Vetëm gjysma e mësuesve mendon se prindërit dëgjohen dhe respektohen në shkolla.
- Ka mjaft prindër që interesohen vetëm për notat e fëmijëve të tyre dhe madje bëjnë presion për to.
- Pengesa kryesore për bashkëpunimin është mosinteresimi i prindërve dhe mendimi që edukimi i takon shkollës.
- Prindërit ndruhen të përfshihen në çështjet e shkollës dhe të kritikojnë mësuesit, për shkak të hakmarrjes që mund të pasojë mbi fëmijën dhe nënvlerësimin që u behet ideve dhe propozimeve të tyre.
- Edhe mësuesit nuk janë gjithnjë të aftë të krijojnë marrëdhëniet e duhura me prindërit

